



# Dukagjini

**Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i VIII i botimit, nr. 105, korrik 2012**

Nr. Llog. BKT 410027968, Shkodër - Albania, Tel. 00355683191817, 0035692328116, internet: www.shoqatadukagjini.org, Kryeredaktor: Lazër Kodra, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro

## Fushatë Rajonale e Ndërgjegjësimit në Kuadër të Thirrjes Kundër Gjakmarrjes **2**

**MEGJITHËSE FENOMENI I GJAKMARRJES DATON QË NË KOHËT E MESJETËS, SHUMË NGA "RREGULLAT" NUK JANË ADAPTUAR ME KOHËT BASHKOHORE. MARRJA E JETËS ËSHTË E NDALUAR ME FE DHE ME LIGJ.**

Duke parë ndodhitë e papërshtatshme dhe jashtë cdo norme jetike në Rrethin e Shkodrës, me një qëllim për të edukuar dhe ndërgjegjësuar opinionin publik në kuadër të thirrjes *po jetës, jo gjakmarrjes*, janë bashkuar shtatë Organizata Jo-Qeveritare: Shoqata Atdhetare "Dukagjini", Drejtësi dhe Paqe, SHIS, Caritas Dioqezan-Shkoder, Fjala e Krishtit, Po jetës, Jo Gjakmarrjes, Eorid Vision dhe Ambasadorët e Paqes.

## "Ibrahim Rugova" në Shkodër ... **4**

Me datën 20 korrik 2012, në mjedisin e Hotel "Evropa", në Shkodër, u bë paraqitja e librit "Ne hap me Rugovën", të autorit Adnan Merovci, njëri prej personave me të afërt të Presidentit Historik të Kosovës, Ibrahim Rugova. Në këtë ceremoni morën pjesë mjaft personalitete të kulturës, të artit, të shkencës e të letrave shqipe.

## Kaltërsi në mes kështjellash **9**

Më së fundi e vendosa të udhëtoja drejt Shkodrës. Autobuzi ishte mjaft komod e shoferi simpatik, ku hera herës shquhej humori i hollë shkodran. Dallohej e folmja e tij me dialektin e ëmbël e plotë muzikalitet të kësaj krahine. Udhëtuam përgjatë asaj rruge Fushë-Krujë-Shkodër që gabimisht në gjuhën popullore quhesh autostradë. Ky koncept ushqehesh jo rrallë nga masmedia, Kryetar, zëdhënës partish e qeveritar shqiptarë. Sa keq kur gjërat ngatërrohen edhe kur politikanët dhe njerëzit e këtij vendi kërkojnë të vrapojnë drejt Evropës së civilizuar kështu të çakërditur e të ... Jo për gjë, por duhet mbushur koka me kulturë e dijeni, se ëndrra nganjëherë kthehet në të kundërtën.

Kërkoj me vështrimin tim të përpijë paisazhet e bukura e të shëmtuara, pyje në flakë e kosha mbeturinash të stërmbushura e që qelbin erë. Shënoi dhe bluaj me vete realitein e djeshëm e të sotëm.

## Pianisti **3**

Aty rreth orës katër të mëngjesit më doli gjumi. Njëpër-mjet grilave të pambyllura mirë, fekste një dritë e dobët, që vinte nga horizonti i largët i Lindjes. Dita e re po nxiton të vijë, mendova dhe mbylla sytë, duke u përpjekur të sjell në mendje fragmentet e ëndrrës që sapo kisha parë – siluetat e turbullta të njerëzve në atë marshim të përzishëm. Po të mos isha duke parë këtë ëndërr dhe diku në mes të kësaj ëndërr të mos më fanitej si në mjegull Monika, kur më doli gjumi, me siguri do të isha ngritur nga shtrati, do të dilja në verandë e do prisja lindjen e ditës së re, ...

Tregim nga LAZËR STANI

## NË KËRKIM TË FAJTORIT...? **7**

Më keq se vetë e keqja është adaptimi me të. Kjo ndodh rëndomtë në Shqipëri. Ne e kemi pranuar atë. Kjo sepse disa nuk dinë, të tjerë e dinë dhe nuk munden, e të tjerë e dine, munden, por nuk duan. Në dëgjohet pak muzikë, lexohet pak letërsi e ndjekim pak teatër. Prandaj s'do shumë mend për të na sunduar. Në jetojmë në turmë, veprojmë në turmë, mësonim në turmë madje edhe votojmë në turmë. Moshë e suksesit karshi turmës ndërtohen mbi ...

## NDAHET NGA JETA MIKU I SHOQATES "ATDHETARE-DUKAGJINI", Prof. Dr. SHEFIK OSMANI **7**


Me datën 22 korrik 2012, pas një sëmundjeje të gjatë, u nda nga jeta profesori i nderuar Shefik Osmani, miku i Shoqatës "Atdhetare-Dukagjini".



## VDIQ MARK NDUE KODRA **6**

Eshte shuar nga kjo jete ne moshen 77 vjecare Mark Kodra, i lindur në Ndreaj në shkurt të vitit 1935, i mbetur jetim nga babai që në moshë të mitur, rrit me mund e sakrificë të mëdha nga nëna Drane dhe axha i babës, Zef Ndoja.

Mark Ndou ishte pinjoll i shtëpisë së Ndoj Pilit (*Pjetrushit*) siç thirrej motit shtëpia e Pjetrush Ndojes. Fjala "burrë" ishte titulli më i lartë për njeriun në kodin e normave etike të malësorit! Bujaria, zgjuarsia, drejtësia nuk mjaftonin të fitojë një titull të tillë, kapaku i artë i burrërisë ishte forca dhe trimëria.



**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP

Mundësoi Botimin:  
GJERGJ LEQEJZA

Ma.di.sh PRODUCTION Kimay Produzione Giacche



# Fushatë Rajonale e Ndërgjegjësimit në Kuadër të Thirrjes Kundër Gjakmarrjes

**MEGJITHËSE FENOMENI I GJAKMARRJES DATON QË NË KOHËT E MESJETËS, SHUMË NGA "RREGULLAT" NUK JANË ADAPTUAR ME KOHËT BASHKOHORE. MARRJA E JETËS ËSHTË E NDALUAR ME FE DHE ME LIGJ.**

Duke parë ndodhitë e papërshtatshme dhe jashtë cdo norme jetike në Rrethin e Shkodrës, me një qëllim për të edukuar dhe ndërgjegjësuar opinionin publik në kuadër të thirrjes *po jetës, jo gjakmarrjes*, janë bashkuar shtatë Organizata Jo-Qeveritare: Shoqata Atdhetare "Dukagjini", Drejtësi dhe Paqe, SHIS, Caritas Dioqezan-Shkoder, Fjala e Krishit, Po jetës, Jo Gjakmarrjes, Eorl Vision dhe Ambasadorët e Paqes.

Përfaqësuesit e Shoqatave janë mbledhur me dt 14.06.2012, ditën e enjte, pranë Sheshit Nënë Tereza, të rreshtuar përballë një morie fëmijësh, të rinjsh, të rejash dhe pjesëmarrësve të tjerë. Mbresëlënëse është fakti që të gjithë pjesëmarrësit ishin të përfshirë në psikologjinë e turmës së thirrjes dhe mbanin në dorë një tullumbace të bardhë, të ngritur lart, me anë të të cilës është pasqyruar dhe trasmetuar mesazhi. Meqënëse "e bardha" është skaji ekstrem i spektrit pamor, dhe meqënëse objektet e bardha të tilla si tullumbacet shfaqen shpesh në natyrë, shpesh janë të lidhura me pastërtinë shpirtërore dhe dëlirësinë, pra në një rast të tillë, mendoj se kemi të bëjmë me një reflektim spekulor të dritës e cila na ndricon në jetën tonë, në nisimat vijuese që do të ndërmarim në respekt të njeriut.

Kjo fushatë ka reflektuar me një specifikë të vecantë, meqënëse ka qënë një procesion i nisur që në orën 10.00, është hapur me një fjalim domethënës pro-jetës njerëzore dhe ka vijuar me një ecje përgjatë Piacës deri tek Gjykata e Rrethit-Shkoder. Në këtë kohë organizatorët e kësaj fushate, ishin të pozicionuar në dimensione të ndryshme; në pikëpamjen e rregullatorit



për të mbajtur normat e ecjes, në pikëpamjes për të vazhduar me përbushjen e qëllimeve të fushatës ndërgjegjësuese etj.

Është domethënëse ndalesa

pranë Gjykatës e cila u pasqyrua këndshëm por edhe me mesazhin reflektus të të rinjve për drejtësi, në rastet sidomos kur njeriu shtyhet për të bërë vetë-gjyqësi, kur ndjen se e drejta e tij është marrë nëpër këmbë në nivel individual dhe

të përpiqemi sa më shumë që është e mundur të parandalojmë.

Në këto raste, të gjithë e dimë se nëse dikush që është në konflikt me dikë tjetër, edhe nëse tenton për të lëvizur i lirë, është më tej dikush tjetër që të kujton



institucional.

Më pas të gjithë ndjekësit e kësaj fushate kanë vijuar me ecjen drejt Prefekturës dhe Bashkisë së Shkodrës për të treguar se pavarësisht nga synimet e mira të politikave aktuale, gjendja psikologjike e mjaft të rinjve, të rejave dhe familjeve është e rëndë dhe e ardhmja e tyre bie përtej klimës të normalitetit njerëzor.

Sepse është për të ndërjerë jo keqardhje në këto raste, por për tu ngritur të gjithë në këmbë njëzëri për të thënë gjithnjë **ndal fenomeneve të errëta** që plagosin dhe vetë-izolojnë jetë njerëzish, në një kohë që pritët të ecim me një frymë perëndimore. Unë kam dëshirë të theksoj se është johumane dhe shumë fallso të nënkuptojmë thënie që vetë-izolimi i njerëzve në konflikt është paranojak dhe jo i bazuar në gjëra konkrete, por të gjithë të interpretojmë fakte aty ku ndodh fenomeni i errët dhe

se "është në konflikt". Është e vërtetë se shumë familje duke u shtyrë nga e mira që kanë brennda vetes, nuk tentojnë të marrin hak apo të kërkojnë dëmshpërbim. Por e kanë shumë të vështirë për të harruar tjetrin që i ka dëmtuar, apo kanosur me jetë. Këto janë rregulla të pashkruara që drejtojnë sjelljen e vetë-izolimit dhe e quajnë atë paranojake apo në shkallë vetëmbrojtëse të paktën. Pavarësisht se tashmë është deklaruar se ky fenomen është ndalur, që strukturat e politikave të vecanta janë ndërtuar, që qendrat dhe projekte të shumta janë krijuar, që nene ligjore kundër vetë-gjyqësisë janë përcaktuar; përsëri është për të pranuar me keqardhje të jashtëzakonshme që fenomene të tilla vazhdojnë.

Përse? Vallë mungojnë ecje të tilla?? Ecim në mënyrë progresive deri diku dhe përsëri kthehem tek i njëjti vend? Më ka lindur kjo pyetje pasi neve të gjithë jemi nisur nga Sheshi

Nënë Tereza, kemi ecur deri tek Gjykata..tek Bashkia..tek Prefektura..tek Rektori, ...tek Radio Shkodra dhe pastaj jemi kthyer përsëri tek Sheshi Nënë Tereza... në pikën ku ishim nisur...

Kjo është ajo që u pasqyrua, me aq sa ka reflektuar në formën time racionale, lëvizja që kanë bërë organizimi i tetë-shoqatave të sipër- përmendura...Mos vallë e kemi të vështirë të ndërgjegjësohemi se duhet të jemi të gjithë të vetëdijshëm për veprimet tona, se arsyeja jonë duhet të jetë më e fuqishme se një impuls temperamentit? Mendoj se kjo lëvizje nuk është me karakter përfitues i mbushur me ekzagjerime për të marrë donacione, por më tepër për të zhvilluar dhe mbështetur procesin e pajtimit dhe për të parandaluar.

Pikërisht këtë mesazh përcollën në mbyllje të fushatës ndërgjegjësuese rreth orës 12.00 edhe të rinjtë e të rejat me manifestimin e tyre të cilët duke kërcyer kishin futur në rreth disa të rinj të veshur me të kuqe duke kryer procesin e pajtimit.

Procesi i parandalimit dhe pajtimit kalon në disa faza të cilët transmetojnë mesazhin se gjetja e paqes dhe kontrolli i vetes është një prej hallkave misionare individuale; ndërsa procesi i pajtimit lidhet më shumë me një mision komunitar që gjithnjë u transmeton të gjithë njerëzve në konflikt se duhet marrë gjërat shtruar, me anë të diskutimeve në grup dhe duke parë dhe besuar edhe anën ligjore gjithashtu. Akoma ekziston një shqetësim i madh i cili vjen si rrjedhojë e shumë faktorëve dhe situatave stresuese të shoqërisë. Jam e mendimit se gjakmarrja nuk është në dëshirën e askujt. Ajo

vjen në mënyrë të pavetëdijshme, të shtyra nga ndjenja të dhimbjes, ankthit ose konfliktit. Kjo gjendje vazhdon të ndikojë sjelljen e njeriut dhe eksperiencën, edhe pse njeriu është i pavetëdijshëm për këto ndikime të padukshme.

Pastaj vijmë tek vetëdija jonë e cila përfshin gjithcka për të cilën ne vihemi të dijeni dhe bëhemi të ndërgjegjshëm. Ky është një aspekt i përpunimit tonë mendor që ne mund të mendojmë dhe të bisedojmë rreth racionalitetit si psh për faktorë si ligji i pastabilizuar dhe drejtësi e pazbatuar por edhe për faktorë të tjerë si psikologjikë, social, ekonomikë dhe kulturorë. Një pjesë e kësaj vetëdijeje përfshin kujtesën tonë e cila nuk është gjithnjë pjesë e vetëdijes apo ndërgjegjes sonë dhe e cila mund të silltet me lehtësi në ndonjë kohë dhe të hyjë në vetëdijen tonë dhe kemi të bëjmë pikërisht me parandërgjegjen. Ndoshta kjo është një pjesë e cila do na duhet me të kujtojmë gjithnjë se jeta e cdo njeriu duhet respektuar, se duhet të jemi me mendje të hapur nga e cila të na dalin vetëm mendime dhe ndjesi pozitive drejt tjetrit. "Të kujtojmë se cdo moment mund të jetë një cast për të filluar për të thënë në emër të jetës e të dashurisë, ti themi Po jetës dhe Jo energjisë negative që gjendet brenda nesh apo që mund të na ushqehet nga ndokush..." .."Të kujtojmë se mund të fillojmë të ecim duke patur besim tek Vetja dhe Zoti dhe të mos humbasim veten tonë nëpër tunelet e të pavetëdijshmes tone. Le të gjejmë farin e dritës së bardhë".

**Nga Mr. Suela Ndoja**



# Pianisti



Tregim nga LAZËR STANI

1.

Aty rreth orës katër të mëngjesit më doli gjumi. Nëpërmjet grilave të pambyllura mirë, fekste një dritë e dobët, që vinte nga horizonti i largët i Lindjes. Dita e re po nxiton të vijë, mendova dhe mbylla sytë, duke u përpjekur të sjell në mendje fragmentet e ëndrrës që sapo kisha parë – siluetat e turbullta të njerëzve në atë marshim të përzishëm. Po të mos isha duke parë këtë ëndërr dhe diku në mes të kësaj ëndrre të mos më fanitej si në mjegull Monika, kur më doli gjumi, me siguri do të isha ngritur nga shtrati, do të dilja në verandë e do prisja lindjen e ditës së re, duke i vëzhguar të gjitha detajet: ndryshimin e vazhdueshëm të ngjyrave në qiellin e lindjes, bashkat e reve, që nga bardhë e zi merrnin dalngadalë ngjyrat e pikturave abstrakte të Jonas Gerard-it, shfaqjen mistike të pyllit në horizont, tutje mbi kurrizin e malit, fluturimin e rrëmbyer të ndonjë shpendi të uritur, gjallërimin e papritur të autostradës, uturimën e trishtuar të makinave që nixtojnë të furnizojnë bulmetoret me produktin e freskët. Por unë mbylla sytë, u ktheva në krahun e mjetat dhe ngjesha kryet fort pas nënkresës, me shpresë se do të rikthehesha prapë tek ëndrra e lënë në gjysmë.

Përpëlitem një copë herë në shtrat, duke u kthyer sa në njërin krah në tjetrin, po gjumi nuk ka sy të vijë. Ëndrra mbetet atje thellë, një tablo e struktur në murin e dhomës me drita të fikura. Edhe Monika, nëse vërtet ishte ajo, u tret si mjegull, duke më braktisur, siç bënte gjithmonë.

Nëse do të kisha qenë Vincent Van Gogh, do të isha ngritur menjëherë dhe sapo ta pija filxhanin e madh me kafequmësht, do zbrisja në atelie, të pikturoja ëndrrën që sapo kisha parë, ose të paktën të skicoja ato fragmente që ishin shpëtuar nga ëndrra. Po se mos varet nga unë. Sado e dhimbshme, më duhet ta pranoj: nuk di të vizatoj as një peisazh të thjeshtë. Duart e mia janë krijuar për piano, jo për penel. Edhe vizatimet e shkollës gjithmonë m'i bënte motra që ishte dy vite më e vogël se unë. Kur mësuesi shënonte notën maksimale në fletoren time të vizatimit, ose deklaronte para nxënësve se "se midis nesh po rritet një piktor i ardhshëm", unë skuqesha, ulja kokën e nuk dija ku të fshihesha nga

turpi. Mësuesi këmbëngulte në idiotësinë e tij: "E shikoni si janë artistët? Kukulur dhe të turpshëm". "Çfarë leshkoje", mendoja me vete dhe e urreja, sikur ai të ishte fjalor për pazotësinë time në vizatim. Gjithsesi, kur kthehesha në shtëpi, i thërrisja motrën nga larg: "Të lumtë, prapë sot more dhjetë në vizatim". Dhe i tregoja fjalët që mësuesi kishte thënë për mua, domethënë, për atë. Motra kënaqej, kapardisej duke shtyrë flokët pas me dorën e djathtë, sytë i mbusheshin me dritë dhe më premtonte se për orën e javës tjetër do të më bënte një vizatim edhe më të bukur.

Atëherë unë kthehesha tek pianoja jonë e vjetër dhe përpiqesha të luaja një melodi që të sillte fëshfërimën e gjetheve në pyll, kur fryn fresku i parë i pasdites, po e kisha të pamundur. Pianoja hakmerrej ndaj pazotësisë time me ca tinguj të çjerrë e të shëmtuar. Ç'të bëja? E braktisja pianon, dilja me vrap nga shtëpia e rendja buzë pyllit dhe, i ulur mbi një breg të vogël, prisja të fryjë fladi i pasdites. Edhe zukatja e pelivesave, që i vinin rrotull një pellgu poshtë këmbëve të mia, më dukej muzikë një qind herë me e bukur, se ajo që unë arrija të luaj në pianon tonë. Me sa mbaj mend, që në atë moshë, shihja në ëndrra piktura të ndryshme, tablo fantastike, që nuk ngjanin aspak me pikturat që shikoja në albumet që sillte babai, sa herë udhëtonte në kryeqytet. I rrëfeja motrës për këto tablo që më shfaqeshin në ëndërr, ia përshkruaja misterin e ngjyrave, efektet e dritës, gjurmën që linte në sfond dielli i sapoperënduar, apo shkëputja e një ylli tutje në një skaj të qiellit, po ajo, si më

kapshme nga sytë.

Edhe tani, ndërsa përpiqem të rindërtoj ëndrrën me pikturë, më duket sikur shikoj motrën buzëgaz, që më përsërit për të njëmijtën herë: "I sheh këto ëndrra ngaqë nuk di të pikturosh si unë". Fjalët e motrës nuk më therin më si dikur, ndoshta ngaqë tashmë e kam një zanat në jetë, që, në mos tjetër, më ka shpëtuar nga vetëvraska.

2.

Piktura e sapoparë në ëndërr është një tablo gjigande, sa krejt faqja e murit përballë shtratit ku jam shtrirë. Nganjëherë më duket e pambaruar, dua të fle sërish, që të vazhdoj ëndrrën, ose unë, ku ta dish, jam dhe në ëndërr, edhe zgjuar njëkohësisht, sepse poshtë tablos lexoj qartë që kam shkruar "Marshimi i të verbërve", shikoj fushën e pafund, një fushë gruri të korrur, dengjet drejtkëndëshe të kashtës, të shpërndara andej këtej (askush nuk është kujtuar t'i mbledhë) dhe kolonën e gjatë të njerëzve që zhvendoset nëpër atë fushë të shkretë, sipas një lakoreje, që duket se do të formojë një qerthull të mbyllur, nëse njerëz të tjerë i shtohen kolonës marshuese. Kam përshtypjen se gjindja në këtë kolonë janë të gjithë të verbër. Nëse nuk do të ishin të verbër, ata nuk do të zhvendosehin kaq ngadalë, nuk do t'i hidhin hapat aq me kujdes dhe nuk do të qëndronin kaq pranë njëri-tjetrit, aq sa të orientohen me vesh, pra të dëgjojnë zhurmën e hapit të atij që kanë përpara, ose me prekje, pra të çikin lehtë kurrizin e atij që paraprin, duke u siguruar se janë me të tjerët dhe nuk kanë humbur. Edhe ai që është në krye duhet të jetë i verbër sepse

dalloj kërcyellët e mbetur pas korrjes së grurit, madje dallohen edhe gjurmët e autokombanjës.

Edhe pse dielli duhet të jetë duke perënduar, (nuk shihet në horizontin e tablos), prapë bën shumë vapë. Shumica e udhëtarëve të verbër janë zhveshur në brez dhe lart, e disa kanë përvjelur edhe pantallonat deri te gjuri, madje janë zhveshur edhe shumë prej grave, dhe ndonjëra prej tyre fshin djersët me bluzën që mban në dorë. Ka në këtë kolonë edhe burra e gra që janë zhveshur krejt, po fundja kujt i bëhet vonë. Në botën e verbër, nuk ka rëndësi se çfarë rrobash mban në trup, se je i veshur apo nuk mban fare rroba. Rëndësi ka të mos ndjesh as ftohtë dhe as ngrohtësi të padurueshme.

Nuk merret vesh nëse janë njëkohësisht edhe të shurdhër, nëse dëgjojnë, bisedojnë me njëri-tjetrin, rrëfejnë histori, flasin për ëndrra me njerëz që shikojnë apo thjeshtë heshtin, sepse askush nuk mund ta dëgjojë tjetrin. Ka të ngjarë që të munduar e të rraskapitur siç janë nga etja dhe uria ata të qëndrojnë në heshtje të plotë, të dëgjojnë ndonjë tingull që vjen nga hapësira a thjeshtë të ëndërrojnë një vijë uji ku të freskojnë këmbët, të shpërlajnë fytyrat e pluhrosura dhe tutje, nën hijen e ca pemëve që nuk ekzistojnë (të paktën në tablon që shihet në ëndërr) të gjejnë të shtruara tryeza plot me ushqime të freskëta dhe pije. Po me atë prijës të verbër që kanë në krye duket se ata nuk do të arrijnë kurrë as të vija e premtuar e ujit dhe as te hijet e pemëve imagjinare ku duhet të jenë shtruar tryezat me ushqime dhe pije. Por as prijës tjetër nuk mund të kenë, ngaqë të gjithë janë të verbër.

Nëse ndonjëri, ose ndonjëra do të kishte dritë në sy, do të kishte dalë me kohë nga kolona, do kërkonte një rrugë tjetër më të shkurtër për të dalë nga kjo fushë e shkretë. Aty nga mesi i kolonës është një grua krejtësisht lakuriq, po që ka një trup aq të bukur sa do të turpëronte edhe gratë e Modigliani-t. Kryet e ka kthyer djathtas e sytë nuk i dallohen, por ngjan sikur shikon në një drejtim tjetër, ndërsa flokët e verdha i derdhen hareshëm në supe dhe shpatulla. Pres që pas një çasti ajo të largohet nga kollona, po si për të dëshmuar verbërinë e saj, ajo vazhdon të qëndrojë aty, në mes të atyre njerëzve që nuk e dinë se ku të shkojnë. Më huton fanitja e shtatit të zhveshur të kësaj gruaje. Pastaj pushtohem nga ankthi. Më tërheq drejt vetes me aq forcë sa unë largoj sytë prej saj.

Nuk ka dyshim se ky është një marshim i pafund, i pashpresë, një rrugëtim i mundimshëm mëkatarësh, të ndëshkuar me mungesën e dritës së syve. Po çfarë mëkati thua të kenë kryer, çfarë blasfemie, që të gjithëve iu shkullën sytë? Mundet edhe të kenë lindur të verbër, ku ta dish. Nëse do ta kishin parë ndonjëherë dritën, me siguri portretet e tyre do të ishin më dramatikë, vuajtja e tyre do të ishte më e thellë, më e padurueshme. Po ata ngajnë të qetë dhe të pashqetësuar në atë marrshim të pasosur pas njëri-tjetrit, duke u kujdesur vetëm që të mos humbin rradhën në kolonë.

(vijon në numrin e ardhshëm)



dëgjonte me vëmendje, duke me zbiruar edhe skutat më te errëta të ëndrrës, ma priste: "I sheh këto ëndrra ngaqë nuk di të pikturosh". E tendoste fytyren sikur po nxirrte një kovë të rëndë me ujë nga fundi i pusit të thellë në fund të oborrit dhe shtonte triumfalisht: "Unë që di të pikturoj nuk shoh ëndrra të tilla".

"Po ti as melodi nuk dëgjon në ëndërr", ia ktheja unë.

"Me ëndrra s'ta del kush", thoshte motra. Kur shqiptonte këto fjalë më ngjante se një buzëqeshje tallëse i mbinte në buzë, një buzëqeshje e beftë që shuhej para se të shndërrohej në buzëqeshje të

ndryshe nga të tjerët që ecin me krahë të varur, ai mban një shkop me të cilin prek tokën, duke kërkuar vendin ku do të hedhë hapin e ardhshëm, çka e bën atë udhëheqës, prijës. Po fusha është aq e madhe dhe aq e shkretë sa asnjë frymë e gjallë nuk pipëtin. Nuk dallohet asnjë shpend në qiell dhe asnjë shtazë anembanë fushës së përfshirë në tablo. As ndërtesa, as kasolle, as xhade, as pemë ndanë një kanal i lumi që rrjedh përkaj fushës së pamatë. Fusha rrethohet me horizont, madje po ta shikosh nga larg ngjan me një peisazh hënor i përmbatur nga një e verdhë e ndritshme. Po nga afër

## “Ibrahim Rugova” në Shkodër ...

Me datën 20 korrik 2012, ne mjedisin e Hotel “Evropa”, në Shkodër, u be paraqitja e librit “Ne hap me Rugovën”, te autorit Adnan Merovci, njeri prej personave me te afërt te Presidentit Historik te Kosoves, Ibrahim Rugova.

Ne ketë ceremoni morën pjesë mjaft personalitete te kulturës, te artit, te shkencës e te letrave shqipe.

Ceremonia është hapur me videospotin e enges ne anglisht “Kosova calls for peace” dhe ka vijuar me një dokumentar te shkurtër për jetën e veprën e Ibrahimit, qe nga momentet e krijimit te Partisë Lidhja Demokratike e Kosovës dhe deri ne detyrën e nderit te Presidentit te Republikës se Kosovës, te cilat sollën para auditorit mjaft emocione dhe qe bënë te rritej me shume respekti për jetën dhe veprën e Ibrahim Rugovës.


Ceremoninë e hapi artistja e teatrit “Migjeni”, e mirënjohura Merita Smaja, e cila here pas here lexonte pjese te veçanta

heronj, udhëkryqe dhe kthesa, shpresa dhe zhgënjime, suksese dhe dështime të karaktereve kombëtare dhe personale; një kohë e trazuar, në peizazhin magmatik të së cilës spikat një nga figurat më të rëndësishme të historisë sonë moderne- ajo e Ibrahim Rugovës.

Vepra komunikon me lexuesin në dy mënyra: nëpërmjet tekstit të shkruar, që përbëhet nga rreth 490 faqe dhe nëpërmjet fotografive dhe dokumenteve nga arkivi personal i autorit. Ky strukturim i jep veprës një karakter të veçantë, duke e bërë tepër autentike, interesante, por edhe shumë funksionale dhe burimore për të plotësuar një mori ekzigjencash të studiuesve të ardhshëm të historisë, të politologjisë, të sociologjisë e te tjera.

\*\*\*

Vendi që figura madhështore e Ibrahim Rugovës zë në këtë vepër, është në fakt vendi që ka dhe duhet të ketë në historinë e nacionalitetit tonë. Vetëm duke



te librit, pasi ju uroj mirëseardhjen pjesëmarrësve, i dha fjalën shkrimtarit Zija Vukaj.

Shkrimtari Zija Vukaj, ne mes te tjerave u ndal: “Libri “Në hap me Rugovën” i autorit Adnan Merovci, për të cilin sot jemi mbledhur, përbën një ngjarje kulturore të vërtetë dhe mjaft të rëndësishme në shumë aspekte. Dua të theksoj që në krye të herës se gjykimet, vlerësimet, komentet, analizat e çdo lloji mbi këtë vepër, paraqesin një mori këndvështrimesh, përsiatjesh gustosh, subjektivizmesh, ndikimesh dhe sfidash të tjera, aq sa çdo përpjekje për ta rrokur me një vështrim të përgjithshëm do të rezultonte shumë e vështirë. Në rastin e një promovimi si ky i sotmi vështirësia kthehet në pamundësi, për shkak të hapësirave të kufizuara të eventit dhe për faktin se leximi i tij duhet t’i nënshtrohet një kohe të gjatë, duke iu kthyer e rikthyer, pra duke u përdorur si një libër shkolle. E them këtë duke u nisur nga natyra shumështrësore e kësaj vepre, e cila ka përmasat e një enciklopedie që hedh dritë mbi një periudhë kryesore të historisë së nacionalitetit tonë. Një periudhë prej më shumë se një dekade, ku janë plazmuar ngjarje dhe

për ta bërë prezentë çështjen kosovare e për ta çuar drejt zgjidhjes dhe veçanërisht për frymën humaniste dhe linjën paqësore të veprimtarisë së vet politike.

Autori përdor termin rugovizëm rreth 140 herë në librin e tij. Ky term përmbledh disa aspekte të shpirtit, të formimit dhe të mençurisë së Rugovës. Diku ky term cilëson durimin, diku aftësinë për dialogje të vështira, diku largpamësinë, diku maturinë, diku intuitën e nganjëherë komunikimin hermetik me një gjuhë ambigue në një frymë, në dukje, tautologjike. Autori ka rrefyer në vetën e parë, në një rrjedhë lineare, me kapituj dhe nënkaptuj që i përgjigjen rrjedhës së kohës; në mënyrën më të drejtpërdrejtë duke i bërë thirrje vetes që në fillim e herë pas here për një objektivitet maksimal. Kjo shpaloset në dhënie e portreteve madhore që parakalajnë në faqet e librit dhe në rrjedhat e ashpra të atyre viteve. A ka panegjizim në raportet e autorit me korifeun e 6 figurave? Mendoj që edhe ka, por me një masë të justifikueshme dhe në balancime të kontrolluara. Kjo vjen për arsye të ndryshme. Mbase një ndër arsyt është edhe fakti që kjo vepër e shk-

## KUSHTRIM BURRA! ERDHI KOHA E PRIMITIVITETIT!

- Më vranë pabesisht! Kujt i bëri keq Marija?!-

“Kushtrim burra erdhi Mesjeta! Më vranë pabesisht! Kujt i bëri keq Marija?! O baballarë qytetarë, fshatarë, malësorë, punëtorë, nëpunës, arsimtarë, gazetarë, poetë e shkrimtarë, ushtarakë, profesorë e akademikë, të mandatuar nga populli dhe pushtetarë që në damarët tuaj rrjedh sadopak gjak shqiptar, pse nuk e ndaloni qoftë edhe me grusht të hekurt gjakmarrjen? Është në detyrën, nderin e dinjitetin tuaj t’i mbronni me të gjitha forcat e mjetet, pa marrë parasysh asnjë sakrificë, të gjithë fëmijët e Shqipërisë. Ju lutet me fytyrë të trishtuar, zemër të copëtuar dhe sy të përletur, shpirti i ish shoqes të klasës së vjaze tuaja....!”

“Katili, kjo hienë gjakësore, i preu në mes me hanxharin e barbarisë mesjetare bulëzimet e para të dëshirave dhe ëndrrave të mia rinore. Ndodhem në shoqërinë e “Engjëjve të Mbretërisë së Qiellit”. Edhe këtu qajnë me dhimbje e ngashërim për mua! Isha shumë e re, 17 vjeçe, e bukur si drita, si gonxhe trëndafili me sy bojë-qielli. Një ditë nëna më tha: Mari, a po shkon me ndihmë gjyshin tand atje në malësi; ata një fatkeqësi e madhe i ka gjete, janë ngujue në shtëpi, toka dhe bagëtia kanë mbet pa njeri...!”

“U nisa ...! Kisha Shpresë ...! Besova ...! Mirë-se-erdhe,-m’ tha gjyshi. Të nesërmen dolëm me punue. Nuk mund ta lija vetëm. Ishte i moshuar. Eh, të shkretit ne! Hija e zezë e gjakmarrjes, e fshehur pas gardhit, me gishtin në këmbëzën e pushkës, na ndoqi hap pas hapi. Papritmas një breshëri plumbash goditi pa mëshirë trupat tonë. Unë dhashë shpirt menjëherë. Na vranë përbindëshat e Ferrit, “Kanuni”, Mesjeta, Denatyrimi i Ligjit, Indiferenca ...!”

“Atje në Parajsë të gjithë më thërrasin shenjtorë! Vetë e lumja Zojë e Bekueme m’a “dhuroi” këtë titull: “E gëzofsh moj bijë, ti je simboli më i spikatur i miliona viktimave të pafajshëm të kësaj botë, të cilët vuajnë e martirizohen nga dhuna e egër çnjerëzore dhe padrejtësitë e tjera të llahtarshme, që s’kanë mbarim edhe mbase kryqëzimit të Birit Tim ...”.

Kam edhe një surprizë tjetër! Është një ndër dhjetë librat më famoz të të gjithë kohërave! “Krahas fatkeqësive të epokës moderne mbi ne rëndojnë një varg i tërë fatkeqësish të trashëguara ... Ne nuk vuajmë vetëm nga të gjallët, por edhe nga të vdekurit. Le mort saisit le vif! ( I vdekuri kap të gjallin! ) K. M. Kapitali.

“E zeza unë! U vrava në emër të Kanunit, “fosile” qindra vjeçare e mentaliteteve dhe zakoneve prapanike, konservatore e reaksionare. Kam lexuar disa kapituj të tij. Ma solli një engjëll nga Lekë Dukagjini. E pabesueshme! Ai dikur paska qenë më i drejtë dhe human se në periudhat e mëvonshme duke përfshi edhe Shekullin e 21-të?! Në malësitë tona koha paska ecur mbrapsht?! Gjakmar-

ruar pas vdekjes së një njeriu altar tingëllon edhe si një ex- voto për shpirtin e një njeriu me cilësi profetike. Një dobi të madhe që sjell vepra është përgjigja për shumë mistere që njeriu dhe lexuesi shqiptar ka akoma në lidhje me ngjarje si Rambujeja, arresti shtëpiak, raportet me UÇK e te tjera, të keqinterpretuara apo të panjohura siç duhet. Së fundi, mendoj se një vepër e tillë është një shërbim i madh që u bëhet të gjithë brezave të lexuesve dhe një nder i veçantë për autorin Adnan Merovci të cilin e uroj për suksesin dhe i uroj suksese të tjera”.

rja qenka bërë më mizore! Si e lejon ai të vriten njerëz të pafajshëm?!”

“Në tubimin në Shkodër ditën e enjte me 5 Korrik 2012 një djalë i vogël i ardhur nga një familje e ngujuar thirri me tërë forcën: “Të shkatërrohet Kanuni”. Ah, Kanuni! Deri kur do të vazhdosh të shuash jetët tona?! Mallkue qofsh qiklop, bombë me sahat, vampir i etur për gjak!”

KANUNI “LEKË DUKAGJINIT”, nga At Shtjefen Gjeçovi, nye i njiqindtetembdhetë, te pjesa “Prita”, theksohet: “Prita do të filloj pushkën mbi burra e jo mbi gra, fmi, mbi shtëpi e mbi bagti”, f. 835; nye i njiqindnjizetepeset, te pjesa “Gjaku shkon për gisht”, theksohet: “Me grani të dorërasit ska punë shtëpija e të vramit, sepse “Grueja e Prifti nuk biejn në gjak, f. 897; “Në Kanu të vjetër të maleve të Shqypnis vetëm dorërasit bijtë në gjak ose aj, i cili tërhiqte, shkreppte e shprazte pushkën e çdo armë kundra nierit”, f. 898; “Shpija e të vramit nuk mujte me ndjekë as me vra tjetërkend prej vllazensh, nipash a kushrijsh të gjaksorit, pos gishtit të dorasit”, f. 899; “Kanuja e vonshme përshin maskullimin e shpis së dorërasit mje në ferishte djepi, kushrinin e nipat e ngiatë, edhe pse të dame, por për 24 orë, në valë të gjakut, e mbase 24 orësh do t’u qitte dorzani shpija e të vrami”, f. 900

“Prindër, e keqja nuk zhduket po nuk i zhgulem deri në një të gjitha rrënjët e saj. Disa shoqata në Shkodër e Tiranë, aktivistë të drejtave të njeriut, dhe ndonjë personalitet i njohur e kanë thënë me shqetësim fjalën e tyre. Edhe ky shkrim, një “pasqyrë” e vogël e ndërgjegjëve të pezmatuara të njerëzve, bën apelim. Ato janë indinjuar në kulm sidomos për indiferentizmin vrasar, të ftohët e acar, i cili ka nxjerrë jashtë-përdorimit “motorët” dhe “levat” e shoqërisë shqiptare.”

“Edhe pranë “Fronit” të Perëndisë ka “jetë”, “flasin”, “shikojnë”, “dëgjojnë”, “shkruajnë” dhe “lexojnë”! “Mësuesja e gjakmarrjes Liljana Luani udhëton çdo fundjavë në zonat e thella dhe troket në dyert prapa të cilave ka frikë, varfëri të tejskajshme, pasiguri, dashuri për jetën, dhimbje, mall, lot, ëndrra dhe dëshira nga më të ndryshme. Mësuese, nëse do mbetem gjallë, do vish në dasmën time?” Ajo meriton respektin dhe nderimin më të lartë! Lum ata prindër që e kanë lindur, rritur dhe edukuar!”

Kudo, në çdo anë, dhe gjithandje egërsira! Si na duron kjo Tokë! Po Dielli pse tregohet kaq bujar ...?! Ne nuk e meritojmë mirësinë e tyre! A ka djem, vajza, motra, nipa e mbase Satani? Si ndjehet për veprën “famoze” që kreu? Po nëna e vrasësit, nëse jeton, a flenë e qetë? A ndjen dhimbje për vajzën e mjerë? Ç’ ka i tha të birit kur u kthye tek ajo?: “Të lumtë pushka o djalë se na nderove ...! Apo tu thaftë dora se vrave dy njerëz të pafajshëm, një burrë plak dhe një vajzë të re që edhe Kanuni i Lekës dikur nuk i ka pas lejuet!”

Nga LUIGJ TEMALI, shkrimtar

Opinion dha dhe mjeshtri Fadil Kraja.

Me autorin e librit, pasi përshëndeti pjesëmarrësit u zhvillua një bashkëbisedim i shkurtër, me pyetje nga auditori dhe me përgjigje te dhëna nga ai.

Kjo ceremoni u mbyll me nje koktejl

\*\*\*

Autorit, Adnan Merovci i urojme suksese te mëtejshme ne krijimtarinë e tij letrare, publicistike dhe ne monografi te tjera te personaliteteve te nacionalitetit tone.

Nga NDUE SANAJ



## VDIQ MARK NDUE KODRA



### Familja

Eshte shuar nga kjo jete ne moshen 77 vjecare Mark Kodra, i lindur ne Ndreaj ne shkurt te vitit 1935, i mbetur jetim nga babai qe ne moshë te mitur, rrit me mund e sakrifica te mëdha nga nëna Drane dhe axha i babës, Zef Ndoja.

Mark Ndou ishte pinjoll i shtëpisë së Ndoj Pilit (*Pjetrushit*) siç thirrej motit shtëpia e Pjetrush Ndojës. Fjala "burrë" ishte titulli më i lartë për njeriun në kodin e normave etike të malësorit! Bujaria, zgjuarsia, drejtësia nuk mjaftonin të fitojë një titull të tillë, kapaku i artë i burrërisë ishte forca dhe trimëria. *Pal Meshi, Ndue Pali, Pjetrush Ndoja, Dedë Noja, Gjon Noja, Ndue Pjetrushi* kanë qenë prototipat nga më të spikaturit në vargun e burrave më të zëshëm jo vetëm të Shoshit, edhe me gjere ne Dukagjin.

Pa asnjë superlativë, në bazë të njohjes simë që kam për të kaluarën e Shoshit, kjo shtëpi ndonëse pa ndonjë ofiq te rendesishem ne hijerarkinë e lartë administrative të fisit, ka qenë në kryekreun e shtëpive më të forta të Shoshit, gjithnjë protagoniste, oponente dhe sfidantja e vetme më e fuqishme e shtëpisë së bajraktarit në rivalitetin e tyre për dominim absolut mbi fisin e Shoshit.

*Pjetrush Ndoja e Vuksan Vata* së bashku me meshkujt e vet kanë qenë në pararojë të ngjarjeve politike më të rëndësishme të kohës që nga 1910 e 1915 me turq e malazet, dhe 1924 në Revolucionin e Peshkopit Noli dhe së fundi, me 1926 në levizjet anti-zogiste të Dukagjinit. Zef Ndue Kodra, axha i Mark Ndout, ka qenë nder simpatizantët dhe aktivistet e kahershëm të LNÇ të drejtuar nga Prof Kolë Prela në Dukagjin.

### Mark Ndou shtetari me i sukseshem dukagjanas i gjitha koherave

Mark Ndou gjatë viteve 1946-1950 kreu shkollën fillore në Koder Shëngjergj. Kushtet e vështira ekonomike të familjes e detyruan të mos vazhdonte më tej. Në vitet 1954-1957 kreu ushtrinë në Tiranë. Këtu u aktivizua me rininë, vazhdoi shkollën e natës duke kryer edhe funksionin e nënoficerit. Leximi dhe libri u bënë moto e jetës së tij, që në moshën 12 vjeçare ishte në gjendje të riprodhonte pjesën dermuese të këngëve në "Lahutën e Malsisë". Studjoi në mënyrë autodidakte letërsi, histori, filozofi, duke formuar profilin e një erudite të mirfilltë. Pas shkollës së mesme, përfundoi Shkollën e Lartë të Partisë "V. I. Lenin". Fillimisht ka punuar si teknik pyjesh në zonën e Dukagjinit, pastaj si Sekretar i Komitetit dhe

me vone i byrosë se Partise ne Dukagjin. Me pas u emërua Sekretar i Komitetit të Partisë së Rrethit në Shkodër, detyrë të cilën e ushtroi për 5 vjet.

Mark Ndou ishte një drejtues i aftë dhe i talentuar, komunikues, punëtor, korrekt, i thjeshtë dhe komunikues me publikun, i prerë dhe i pakompromentueshëm ndaj padrejtësive, hatërëve dhe trefëve që gjallnonin nën rrogosë.

Antikonformizmi tipik e pengoi të ngjitej akoma më lart në karrierë, por e bëri dinjitoz dhe shembull model të njeriut të përkushtuar me të gjitha energjitë ndaj punës, rregullit dhe ligjit që është a-ja e funksionimit të çdo shteti. Aftësitë organizative dhe përkushtimi i tij ishin të pakontestueshme, por gjithsesi mbeti i pa dëshiruar në "kulmin" e KP te rrethit Shkoder. U gjet marifeti për ta çuar atje ku ishte fronti më i vështirë, Kryetar i Kooperatives se "Tipit te Larte" në Bushat, në njërin nga kooperativat me resurse natyrore më të bollshme, por nga më problematike e të gjithë Rrethit. Kooperativa bujqësore e "Tipit të Lartë" të Bushatit, gjatë pesë viteve të qëndrimit të tij u shndërrua në një nga ekonomitë më të përparuar në shkallë kombëtare. Suksesi që pati në Kooperativën e Bushatit i hapi udhën drejt zyrës së Kryetarit të Komitetit Ekzekutiv të rrethit të Lushnjes, pa dyshim njëri nga rrethet që mbante peshën kryesore në prodhimin e drithrave të bukës në shkallë vendi. Në krye te detyrës se ekzekutivit te këtij rrethi me rendësi strategjike per vendin, qëndroi nga viti 1977 deri në vitin 1983. Janë vitet kur u deklarua zyrtarisht arritja e prodhimit të bukës në vend, pa dyshim ishte Muzeqeja hambari që duhej të plotësonte defiqitet e shumë rretheve te tjera defiqitare.

Përkushtimi dhe korrektësia në punë solli përplasjen e antikonformistit kokfortë me tarafet e klaneve të Lenka Çukos. "*Bija e lalës, e forta e Byrosë Politike*", e largoi politikisht "malokun" e padëshirueshëm. Më pas ka punuar si kryetar Kooperative në Velipojë, Drejtori i Ndermarrjes së Bonifikimit dhe së fundi Kryetar i Komitetit të Koplikut. Mark Ndou rriti dhe edukoi tre vajza dhe një djalë shembullor, intelektual, profesionist dhe me reputacion të gjerë shoqëror. Mark Ndou se bashku me Ndue Marashin jane dy dukagjinasi e parë dhe te fundit që arritën deri ne postin e Krytarit të Komitetit Ekzekutiv (*niveli i mesëm ne piramidën e pushtetit ekzekutiv*). Fatkeqësisht as dje në komunizëm as sot në kapitalizëm asnjë dukagjinas tjetër nuk e ka kaluar këtë prag pertej të cilit ndodhet "molla" përjetësisht e ndaluar e pushtetit për dukagjinasi në të gjitha kohërat.

Mark Kodra pertej pikpamjeve idologjike ka mbetur ne kujtesen e qytetarise shkodrane, te fusharakve te Nenshkodres, mirditorve, malsorve dhe muzeqarve si personifikimi i njeriut vital, kuadrit te shembullor, nje emer qe i ben nder Dkagjinit dhe ja rriti prestigjin vendlindjes kudo qe punoj per 40 vjet me radhe.

Nga PRELE MILANI

## Këngëtarët e zonës sonë, misionarë të traditës, kulturës e zhvillimit

Zona jonë ka trashëguar dhe mbrojtur nga erozionet e kohës traditën e bujarisë, besës, urtësisë, trimërisë e te tjerë, në të cilat është identifikuar, vlerësuar dhe ka mbijetuar. Ato i ruajtën brez pas brezi si vlera të veçanta të trashëgimisë për malësorët dukagjinasi. Ashtu si bukën, që malësori ekspozonte për mikun, e që tregonte bujarinë e tij, pushkën e varur në mur, që ishte element i sigurisë, në odën e mikut gjendej edhe lahuta, çiftelia dhe fyelli, që mikut, shokut e dashamirit, t'i krijohet një ambient i ëmbël, relaksues dhe dashamirës. Dukagjinasi e ka dashur këngën, e ka krijuar, e ka interpretuar me pasion e dashuri, në mjedise dasdash dhe gëzimesh, në bjeshkë afër krojeve e në hijen e mrizave, gjatë punës apo udhëtimit, kudo e kurdo nga çdo brez në forma e mënyra ashtu siç e ka ndërjet vetë malësori.

Në shërbim të këngës e këngëtarit, janë shfrytëzuar mjete rrethorë prej druri, apo vegla të thjeshta që shërbenin për punimin e instrumenteve popullore. U zgjodh druri i arrës, i manit, të palnës, të thanës, lëkurën e kecit, lëkurën e macës, qimet e kalit të pa shaluar, rrëshirën e pishës, bakrin ose tunxhin për fyellin, gjethen e ahut ose të frashërit, i provuan kush jep tingull bukur, kush punohet, gdhendet dhe është rezistent, këto e cilësi të tjera, u përzgjedhën për instrumente popullore, për tu shoqëruar një pjesë e këngëve folklorike të trevës tonë, gjatë viteve dekadave e shekujve.

Çdo fshat, por dhe afërsisht çdo familje deri sa u futën radioja, televizori dhe mjete te tjera të elektronikës, kishte këngëtarë, instrumentistë, interpretues të këngës majakrahu, këngëtare kapuçash, putirxhinjë e te tjerë. Studiuat të huaj, por edhe shqiptarë kanë gjetur burime të rëndësishme studimore, për etnografinë, folklorin e në përgjithësi të kulturës popullore në zonën tonë. Të tillë kanë qenë studiuesit Shtjefën Gjeco-vi, Rrok Zojzi, Ramadan Sokoli, Kahreman Ulqini e te tjere.

Krijuesit, interpretuesit e zonës sonë u rritën nga brezi në brez në numër, por edhe në cilësi, duke u identifikuar nga forma, mënyra dhe interpretimi i këngës folklorike. Ndryshimet e sistemeve nuk ndikuan në traditën dhe kulturën e trashëguar, përveç ndryshimeve ne fillim të viteve 90-të. Kultura në përgjithësi e në veçanti ajo e traditës, pësoi goditje të rëndë, duke dalë jashtë funksionit shumë institucioneve të kulturës, u keqpërdor baza materiale u larguan shumë profesionistë nga ky sektor. Njerëzit rendën pas politikës, biznesit e fitimit duke haruar kulturën dhe artin. Në këtë sektor

u prishën edhe ekuilibrat nga lëvizjet demografike dhe emigracioni, si dhe nga rrymat e kulturës së huaj të cilat qenë tabu për vendin tonë deri në fillim të viteve 90-të.

Populli thotë: - "Çdo e keqe, e ka një të mirë". Vërtetë lindi nevoja që koha të thërrasë në skenë, brezin e këngëtarëve, instrumentistëve dhe e krijuesve dukagjinasi që sot zëri, talenti dhe pasioni i tyre, ka kaluar kufijtë shtetërorë, kanë fluturuar mbi dete e oqeanë, është bërë pjesë e festave dhe e gëzimeve familjare kudo ku ka jo vetëm dukagjinasi, por dhe shqiptarë të Veriut të Shqipërisë, Kosovës, Malit të Zi, Maqedonisë e të diasporës në përgjithësi.

Zëri i Fran Kodrës, Ndue Shytanit, Nik Carkut, Gjovalin Prronit, vëllezërve Shani, Mhill Cunit, vëllezërve Piniqi e te tjere. dëgjohet në dasma e gëzime, emisione televizive, të regjistruara në vidioklipe, CD, celulare dhe forma të tjera që sot ka tregu dhe elektronika. Ne që e ndiejmë ritmin e vlerësojmë vargun, njohim motivin e këngës, ndjehemi komod e të lumtur, që këta misionarë të traditës dhe kulturës të zonës sonë, po sjellin art zhvillim dhe integrim. Këngëtarët i duan, i respektojnë, dhe i dëgjojnë njerëzit e thjeshtë, politikanët, biznesmenët, të rinjtë e të moshuarit, të cilët gjejnë tek këngët e këtyre këngëtarëve përveç artit, kulturës dhe pasionit edhe mesazh për të shkuarën të sotme dhe të ardhmen. Ata lartësojnë personazhet, rritin vlerat e traditës, afrojnë peizazhin e maleve, ringjallin ngjarjet që duhen vlerësuar, nxisin për të ardhmen duke argumentuar vlerat e të



kaluarës.

Ne kemi nevojë për këngë në këtë kohë plot kriza. Kemi nevojë të njohim veten, kohën dhe shoqërinë. E kemi provuar se me forcë nuk ecet përpara, dhe se askush nuk po na përfaqëson më mirë dhe më shpejt se kënga dhe këngëtarët e trevës tonë. Na duhen sa më shumë këngë dhe këngëtarë. Koha e sotme nuk ua imponon të këndojnë vetëm në një studio, në një "tervese" a në një aktivitet. Tregu kërkon konkurrencë, cilësi e krijime të reja e te larmishme. Ne krenohemi me ju dhe u urojmë sa here u dëgjojmë: U lumtë goja, e u këndoftë zemra!

Nga ZEF BARI

## NDAHET NGA JETA MIKU I SHOQATES "ATDHETARE-DUKAGJINI", Prof. Dr. SHEFIK OSMANI

Me datën 22 korrik 2012, pas një sëmundjeje të gjatë, u nda nga jeta profesori i nderuar Shefik Osmani, miku i Shoqates "Atdhetare-Dukagjini".

Me profesor Shefikun u njohem në muajin tetor 2006, në veprimtarinë për dorëzimin e titullit "Qytetar Nderi" të qytetit të Shkodrës profesor Kole Preles. Profesori kishte qene nxënës i Kole Preles. Sa i thame që do të zhvillohej një ceremoni për Profesor Kole Prelin, u tregua menjehere i gatshëm të vijë në Shkodër, dhe erdhi. Në atë ceremoni përshëndeti dhe fjalet e tij ishin lapidar për ne, që tregonin vlerat intelektuale të tij dhe mbi të gjitha vlerat si NJERI.

Në atë vit, në muajin nëntor, në kuadrin e 100 vjetorit të profesor Luigj Marlekes, ose At Jak Marlekes, Shoqata "Atdhetare-Dukagjini", pergatiti Simpoziumin Shkencor, me të me: "Një misionar në shërbim të Kombit". Në këtë simpozium jo vetëm që ndihmoje, por dhe mori pjesë me një temë të veçantë kushtuar këtij misionari, për të cilin profesori kishte pergatite dhe botua një monografi, me titull "Një misionar në shërbim të kombit".

Profesori mbeti mik i shoqates dhe i dukagjinasve. Me humbjen e tij, jo vetëm bashkëshortja-"Mesuesja e Popullit"-Urti Osmani-humbi bashkeshortin, një shokë, një mik; vellai profesor Tomorr Osmani-humbi vellane, të aferm, miq e shokë të tij-humben njeriun e tyre të zemres, humben bashkepunetorin e tyre shkencor, por dhe në humbjen një mik të sinqertë dhe veshtirë të zevendesohet me.

### Jeta e profesorit

Profesori ka lindur në qytetin e Shkodrës në vitin 1923. Ai, me pasionin, që në rininë e tij ju perkushtua dijes e shkences, ai i perkushtua tërë jetën edukimit dhe mësimin të brezit të ri. Pas mbarimit të studimeve të larta për pedagogji jashtë vendit, shërbeu me perkushtim të veçantë në disa shkolla, që pergatitën mësuesit e rinj. Gjurmët e pashlyera të tij i gjejmë sot e kësaj dite, në qytetet Shkodër, Peshkopi e Tiranë. Më pas, vite të tëra shërbeu inspektor e gazetar në Ministrinë e Arsimit e Kulturës dhe punonjës shkencor në Institutin e Studimeve Pedagogjike.

Gjatë jetës së tij, prof. Shefik Osmani shkroi e publikoi shumë vepra didaktike e shkencore nga fusha e arsimit, si dhe qindra artikuj e studime, në gazeta e revista të ndryshme. Me aftësitë e pjekurinë e tij pedagogjike e shkencore, me zellin e këmbënguljen e dallueshme të tij për

kërkime dhe studime të thelluara, aritë të shkruajë e publikojë afër 40 tituj librash kërkimorë, studimorë e shkencorë.

Në mes punimeve dhe botimeve të tij, një vend shumë të merituar zenë botimet për shkollat me mësim plotësues, në shërbim të fëmijëve të Diasporës Shqiptare. Është domethënësi pohimi, në një shkrim të publikuar, për ndihmesën shumë të çmuar në këtë fushë të veprimtarisë së tij: "Kur të shkruhet historia e Diasporës Shqiptare, krahas shumë pedagogëve të shquar, që janë marrë me rëndësinë e gjuhës amtare larg Atdheut ose me mësimin e gjuhës shqipe të brezat e rinj, një vend nderi i takon, padyshim, prof. dr. Shefik Osmanit".

Për punën e palodhur dhe të shumanshme pedagogjike dhe kërkimin shkencor, në fushën e arsimit dhe të mendimit pedagogjik shqiptar, Shefik Osmanit iu dha grada "Doktor i Shkencave" dhe titulli "Profesor" e është nderuar me dekorata e urdhëra të ndryshëm, nga Presidenti



i Republikës së Shqipërisë.

Ndihmesa shumëvjeçare e tij, pedagog, studiues e botues në fushën e arsimit nacional shqiptar, do të kujtohen dhe vlerësohen jo vetëm sot, por ato do të u qëndrojnë edhe viteve pasardhës.

Me këtë rast, e ngushllojmë bashkëshortin e prof. dr. Shefik Osmanit, Urtinë; vëllain Tomorin dhe familjarët e tjerë, për humbjen e njeriut të tyre të dashur.

Humbja e profesorit pikëllon edhe të gjithë kolegët, ish-nxënësit, miqtë e dashamirët dhe bashkëpunëtorët e tij të shumtë, si brenda e jashtë Shqipërisë.

I paharruar qoftë kujtimi i tij!

Nga Ndue Sanaj, Gjergj Leqejza, Prele Shytani, Prele Milani e Lazer Kodra

## NË KËRKIM TË FAJTORIT...?



Më keq se vetë e keqja është adaptimi me të. Kjo ndodhë rëndomtë në Shqipëri. Ne e kemi pranuar atë. Kjo sepse disa nuk dinë, të tjerë e dinë dhe nuk munden, e të tjerë e dine, munden, por nuk duan. Në dëgjim pak muzikë, lexojmë pak letërsi e ndjekim pak teatër. Prandaj s'do shumë mend për të na sunduar. Në jetojmë në turmë, veprojmë në turmë, mendojmë në turmë madje edhe votojmë në turmë. Modelet e suksesit karshi turmës ndërtohen mbi baze e instinkteve primitive të dhunës, urrejtjes dhe varfërisë. Prandaj dëgjim kaq shumë urrejtje dhe mllëf në ligjërimet politike, në bisedat televizive deri edhe në jetën e përditshme tonën. Po të dalësh në rrugë përherë e më shumë sheh fytyra të ngrysur që ecin, që shprehin këtë zbrazëti butësie e dashurie njerëzore. Fundja shumë rrasë kapitje shpirtërore të trashëguar, por edhe të krijuar nga zhvillimet e ditës. Të dyja ndihmojnë njëra-tjetrën në një rreth vicioz.

Në paradoks me këtë kemi shprehjen e lashtë që nga koha e Zogut: "Shqipëria po lulëzon". Ne me të vërtetë jemi më mirë se ishëm. Kjo për meritë të askujt përveç Ligjit të Evolucionit. E ky ligj na thotë se për të pasur një Shqipëri evropiane duhet të presim shekuj. Por a matet jeta e një individi me shekuj siç matet jeta e kombit?

Në këtë tablo shumë njerëz mundohen të gjejnë një kurban për të gjithë situatën. Disa thonë e ka fajin politika, të tjerë fqinjët tanë, të tjerë fajësojnë besime apo krahina të ndryshme. Populli ankohet për udhëheqësit e tij, për paaftësi dhe korrupsion. Po me veten e tyre edhe politikanët ankohen për një popull dembel dhe injorant. Dalim në një situatë ku te gjithë ne jemi edhe fajtorë edhe viktima. I njëjti arsyetim vlen edhe për kriminalitetin, korrupsionin e të gjitha problemet që trazojnë shoqërinë tonë.

Një pjesë tjetër e shoqërisë mundohet të mos i shohë me shumë shqetësim këto probleme sepse këto i përkasin edhe shoqërive të tjera. Shpesh herë japin edhe shembuj kur këto probleme janë edhe më evidente. Ajo që shtrohet para nesh në këtë rast është se çfarë modeli duam të ndjekim dhe më kë duam të krahahemi. Kur duhet të flasim për të keqen, kur ajo na kundërvihet kundër nesh apo që kur ajo lind?

Si përfundim unë mendoj se për ne si shoqëri ka ardhur momenti të thellohemi dhe të drejtohemi drejt një reflektimi personal. Poeti i madh Azemi Shkrelë e shpreh shumë bukur këtë ide kur thotë:

"Sikur të takoheshim me veten sy më sy,  
Vallë kishim për t'u puth, apo kishim për t'u pështy."

Ne duhet të takohemi më veten tonë. Ta shohim vetveten në pasqyrë dhe të kuptojmë se ç' pjesë e këtij faji rëndon mbi ndërgjegjen tonë. Shumë popuj e kanë bërë këtë dhe kanë pasur atë zhvillim që ne e presim. Kjo do të na bëjë të njohim më mirë të kaluarën, të kuptojmë më mirë të tashmen dhe të drejtojmë më mirë të ardhmen.

Nga FLORENC BUXHA, mjek

## U nda nga jeta, Martin Çuni

Martin Nd. Çuni, u nda nga jeta me 14 qershor 2012.

Ai lindi në fshatin Theth, të komunes se Shales.

Ai ishte njëri i thjeshtë, dashur, komunikues. Ai ka punuar me perkushtim në detyra të ndryshme në shërbim të komunitetit dukagjinës, në veçanti në sektorin e tregtisë (NTSH/2).

Ai, në moshën e ushriës ka qene pjesemarrës në Brigadën e II Sulmues. Ka qene pjesemarrës në aksione të ndryshme për ridnertimin e vendit. Për punën e bere, është dekoruar nga Presidiumi i Kuvendit të Shqipërisë, si dhe me dhjetëra tituj nderi në aksione e kolektiva ku ka punuar gjithë jetën e tij, deri në ndarjen nga jeta.

Martin ka qene veterane, anetare i organizates se Veteraneve dega Shkoder dhe anetar i Shoqates "Atdhetare-Dukagjini".

Nik Toma, Ndoc Grima, Gjergj Çuni, Marash Malaj, Pal Lera dhe Nik Vidhi.



## Përse burrat i tradhtojnë gratë?

Si do të silleshin burrat, nëse gratë e tyre do tua lejonin që të shkonin në krevat me një grua të huaj?

Sipas një studioje amerikane, përgjigjja do të ishte kjo:

Sigurisht që do të shkoja me gruan e huaj - 20 %

Ndoshta do të shkoja me gruan e huaj - 10 %

Ndoshta nuk do të shkoja me gruan e huaj - 33 %

Sigurisht që nuk do të shkoja me gruan e huaj A - 37 %

Në çdo rast dhe kudo, dëgjon afere të meshkujve me gratë e huaja. Ndoshta do të duhet kohë që njerëzimi të harrojë afërën e presidentit të Amerikës, Bill Clinton me praktikante e Shtëpisë së Bardh, Monika. Presidentë, kryeministra, ministra, politikanë, vipa, dhe ... meshkuj te të gjitha kategorive, e kanë provuar ose ëndërrojnë ta provojnë gruan e huaj në krevat. Në Gjermani, çdo ditë mendohet se shkojnë 1,5 milion meshkuj në bordello.

Përse ndodhë kjo!? Përse meshkujt janë, seksualisht kaq të papërbajtur!?

Sipas hulumtimeve të bëra nga specialistët psikologë në ketë fushë, arsye është se burrat, me kalimin e kohës, e humbasin interesin seksual me të njëjtën grua. Pas një viti marrëdhënie me të njëjtën grua, interesi seksual i meshkullit zbret deri në 50 për qind në krahasim me muajin e parë të lidhjes. Zbritja vazhdon, gjithnjë e më shumë me kalimin e kohës.

Ky efekt, ndoshta do të kuptohej shumë më mirë, duke marrë për bazë reagimet mashkullore nga bota shtazore. Nëse do të merret një ka dhe do të dërgohet tek lopa që kërkon ka, ai në fillim do të ndjehet shumë mirë dhe menjëherë do të mundohet që ti tregojë asaj aftësitë e veta mashkullore. Nëse kau do të bjerë në kontakt me të tjera lopë, ai do të tregojë po të njëjtat aftësi, por nëse do të jetë në stallë me njërin nga ato, aftësia e tij seksuale bien. Në botën shtazore, tek meshkujt, aftësia seksuale me femra të ndryshme, mbetet konstante, si me të parën dhe ... me të dymbëdhjetën.

Sipas studiuesve, shkaku është substanca kimike, e quajtur DOPAMIN.

Eksperimentet kanë treguar se tek minjtë meshkuj, kur ata janë vetëm me "bashkëshorten" e tyre, sasia e dopaminës në gjak, ulet shumë. Sapo ata shikojnë një "damë" të huaj, dopamina shpërthen furishëm në gjak. Kështu funksionon edhe truri i mashkullit njeri, sqaron psikologu.

Shkencëtarët i kanë vënë një emër këtij fenomeni, Coolidge-effekt, sipas një anekdote të presidentit amerikan, Calvin Coolidge (1872-1933). Ai, bashkë me gruan e tij, shkoi për vizitë në një fermë bujqësore ku gruaja e tij, siç duket u bë kurioze ndaj një gjeli që ja hipi një pulë. Kur dikush i tregoi se gjeli këtë punë bën, deri në dymbëdhjetë herë në ditë me pulat, siç duket ajo ishte përgjigjur: "Thuajani, mundësisht, burrit tim, zotit president".

Kur presidenti u informua mbi potencialin seksual të gjelit, ai u përgjigj: "Desha të dijë nëse gjeli gjithnjë e bën këtë gjë me të njëjtën pulë?"

Kur u sigurua se gjeli, çdo herë e bënte me një pulë tjetër, ai vazhdoi: "Thuajani këtë gjë gruas time!"

Studiuesit kanë arritur në konkluzionin se fajtor për rënien e dëshirës seksuale të botës mashkullore, me të njëjtën damë, është Libido. Shkaku duhet të jetë biologjik. Sipas evolucionit biologjik, me prejardhje gjenetike.

Meqenëse meshkujt nuk mund ta sigurojnë shtimin e popullsisë, shtazore apo njerëzore, vetëm me një femër, diku në trurin e tyre, ekziston një mekanizëm i nxitjes për shumim, i cili, pas një pauze, e zgjon libidon. Meshkujt, biologjikisht janë programuar në mënyrë të atillë që, spermën ta shpërndajnë në sa më shumë femra, për të siguruar mbijetesën e species.

Psikologu kanadez, Dennis F. Fiorino, ka zbuluar bazën biokimike të kësaj dukurie. Ai mendon se, dëshira seksuale, është e fshehur diku në thellësitë e trurit të mashkullit. Kjo zonë "alarmi" përbëhet nga një sistem nervor i posaçëm, që sh-

trihet nga truri primitiv i mesëm, truri i ndërmjetëm dhe deri tek sistemi limbik. Kur mashkulli, njerëzor apo shtazor, shikon damën e huaj, qelizat nervore informojnë menjëherë qendrat e prodhimit të drogës dopaminë, e prodhojnë atë dhe e lëshojnë në gjak.

Që dopamina, e rritë në mënyrë të menjëhershme dëshirën seksuale, kjo është vërtetuar shkencërisht nga studiuesit biopsikologë. Në rastet e kontakteve të minjve meshkuj, të mbyllur në kafaz, me damën e re, sasia e dopaminës ka shkuar deri në 90 %. Pas kontaktit seksual, është ulur deri në dhjetë për qind.

Tek bota njerëzore, midis programimit biologjik të meshkujve dhe moralit, ekziston një hendek i madh. Programimi i nxitës, morali nuk i lejon. Pavarësisht nga programimi, njeriu është në gjendje që ta vërë nën kontroll vetveten, në çdo rast dhe rrethanë. Gruaja, me veprimet ose mos veprimet e saj, është një faktor i rëndësishëm për moralin e burrit.

Nëse do ti heqim për një moment trysninë e programimit, arsye që burrat shkojnë me të huaja, është e njëjta me atë të grave: "Ato kërkohen diçka, jashtë shtëpisë, që nuk e kanë në shtëpi ose, që mendojnë se nuk mund ta arrijnë. Logjika ta thotë se, arsyeja kryesore që burrat i tradhtojnë gratë, nuk është seksi por, dëshira për të gjetur tek dikush tjetër atë që ju mungon në partneritet.

"Pas katër vjet martese, e tradhtova gruan. Shkova me një shoqe të punës. Jo se ajo ishte më e bukur se gruaja e ime. Përkundrazi, e imja ishte shumë më e bukur. Arsyeja ishte se tek ajo gjeta diçka tjetër që i mungonte gruas time dhe sigurisht që nuk do ta arrinte kurrë. I mungonte femërorja. Delikatesa e femrës. Më dridhej trupi dhe më neveritej kur e shikoja të bënte rolin e hamallit ... Kolegeje e punës ishte plot kreativitet dhe fantazi. Dëshira për të qenë kudo dhe sa më gjatë me atë, nuk më mbaronte kurrë. Nuk ka gjë më të vështirë se sa kur në shtëpi dëgjon të flitet vazhdimisht vetëm për parat, borxhet, mobilet, fëmijët ...". Kështu tregon një 35 vjeçar i cili pas gjashtë

vjetësh martese u nda me gruan.

Sipas këtij tregimi, shkuarja e burrave me të huajat, jo gjithnjë është qëllim në vetvete. Sipas statistikave, vetëm 14 për qind e burrave, të mposhtur nga fuqia gjenetike e shpërndarjes së spermës, janë të mendimit se, shkuarja me të huajat është e domosdoshme.

"Natyrisht që e imagjinoj veten me një femër të bukur në krevat, si nga ato që i njoh dhe ato që nuk i njoh por, nuk e kam bërë kurrë dhe as që kam ndërmend ta bëj një gjë të tillë. Njoh shumë burra, të cilët për një marrëzi me një të huaj, kanë shkatërruar familjen. Prandaj e pyes veten, përse duhet të rrezikoj kot?", mendon një dyzet vjeçar i martuar.

Megjithatë, ne burrat nuk heqim lehte dorë nga e huaja. Përse!?

Le të mendojmë të kundërtën: -Çfarë e shtynë një grua që ta tradhtojë burrin? Mos vlerësimi i saj në familje? Fakti se jeta e saj seksuale dhe në të gjitha drejtimet e tjera, rënda familjes nuk është gjë tjetër veçse e një skllaveje? Se ajo, ndoshta kërkon pak tension, aventurë dhe, përse jo, pak rrezik? Ndoshta se i ka ardhur koha për tu hakmarrë për padrejtësitë e përjetuara nga burri i saj? Ndoshta për ta vërtetuar atraktivitetin dhe dinamikën e saj se, nuk është më pak se ajo e natës së martesës?

Tamam, ajo që i bën gratë të tradhtojnë, është edhe për burrat.

Metoda më e mirë, për ta parandaluar burrin nga tradhtia, është që, gruaja të sillet me atë, ashtu siç do të dëshironte që ai të sillej me gruan. Nëse gruaja dyshon se burri është në rrugën e tradhtisë ose e ka tradhtuar, nuk është koha për tu grindur. Është momenti që ajo ti krijojë atmosferën e duhur burrit brenda familjes, sa nuk është vonë.

Arma më e fuqishme për ta çarmatosur burrin, është lavdërimi. Më shumë përqafile, më shumë puthje, më shumë përkëdhelje, më shumë romantikë dhe sa më pak ose aspak brutalitet. Burrat në përgjithësi nuk e durojnë dot brutalitetin. Të gruas, jo dhe jo.

Nga LEKË IMERAJ,  
shkrimtar dhe përkthyes

## ZONA E LEKBIBAJVE, NJË PERLË E NATYRËS SË DUKAGJINIT

Zona e Lek Bibajve, ose Nikaj Mërtur... shaljanët e quajnë "përtejfaqë", sepse i ndan mali dhe i lidh qafa historike e Agrit ... të tjerët e quajnë Malësi e Gjakovës, ashtu si zona e Shalës është Malësi e Pejës, që të dyja së bashku janë Rrafshi i Dukagjinit. Unë dua të shkruaj prej nga e kam parë dhe nga e kam soditur atë zonë ... prej zonës së Kolçit ...

Ishte viti 1958, sapo ishte hapur rruga e makinës Shën Mëri-KolGecaj (sot qytetit i Bajram Currit) udhëtuam nga Shkodra me një autobus të vogël dhe arritëm në Kolë Gecaj .... Që andej u nisëm në këmbë për në Lekë Gecaj ... që andej u nisëm në këmbë për në Lekë Bibaj (atëherë aty nuk ishte hapur ende rruga e makinës). Ne po shkonim për festën që kremtonte Mërturi, meqë nëna ime ishte bijë prej andej.

Udhëtuam me shtegtarë të ndryshëm,

kaluam përmes pyllit të Sërrnicës, i cili sapo kishte filluar të shpyllëzohej ... më pas u kthye në një tokë pjellore. Udhëtimi që i gjatë dhe i lodhshëm, por bukuritë e natyrës, bisedat me njerëzit, tregimet e tyre për zonën në të cilën po udhëtonim, e bënë udhëtimin të bukur dhe mbresëlënës ... kështu arritëm dhe në Qafën e Kolçit, për të cilën banorët tregonin legjenda e përralla komike e dramatike. Nga Qafa e Kolçit gjithë zona dukej e gjelbëruar dhe me shumë burime ujore, përpara shfaqej Maja e Hekurave, një tempull i bukur i natyrës, por në horizont dukeshin bukuritë e tjera gjer tek Fshati Curraj i Epërm.

Padyshim menjëherë të vijnë ndërmend se në këtë zonë kanë lindur njerëz të shquar, burra trima e të urtë, gjithashtu patriot si: Bajram Curri (Dragoi

i Dragobisë), Prel Sula, Kreshniku i Qafës së Agrit që së bashku me Mehmet Shpendin e trima të tjerë, në vitin 1910 shpartalluan forcat armike turke, gjithashtu Gjelosh Ramaj, Tunxh Myftari, Shytan Brahimi si dhe Zeqir Dema, Mar Elezi, Beqir Nduq që ishte gjenerali i ushtrisë çlirimtare anti-nazifashiste.

Nga kjo zonë kanë dalë intelektualë si: Ndue Gjoka, Kolë Tahiri, Ndoc Papeleka, Sokol Progrri si dhe mësues, Zef Doda (nipi i Prelë Tulës), Nikë Çokaj, Liza Sheqeri, Bush Gjoka, Pjetër Halili që kanë shërbyer në shkollat e zonës, si dhe mjekë, officer e te tjere. Liza Sheqeri ka punuar si mësuese dhe drejtuese në shkollat e zonës deri sa ka dalë në pension. Ajo si mësuese historie, fliste e apasionuar për zonën dhe ishte krenare për vendlindjen e saj. Për Mërturin; - ajo thoshte se e ka marrë emrin nga trimat që merrnin turr në luftë kundër turqve, dhe kështu evoloi emri Mërtur, ndërsa për Majën e Hekurave; - se në epokat e shkuara historike ka qenë e rrethuar nga uji dhe aty janë

akustuar anije (kjo ishte perrale, ose legjende) e kështu ajo fliste për bukuritë e Nikaj Mërtur. Nga kjo zonë kanë dalë artistë siç ishte rapsodi Zef Avdia dhe që e vazhduan artistët: Gëzim Nika, Prelë Mri-sha, Gofile Papeleka, Zef Beka e te tjere.

Gëzim Nika, me vëllezërit e tij, përbëjnë një grup artistash të lindur, ndërsa vetë ai është një artist që falë dhuntive që i ka dhënë natyra, si dhe punës së tij, admirohet nga të gjithë, kudo që ka shqiptarë. Ai u vlerësua si artist i përmasave kombëtare, zëri i tij u dëgjua edhe në 100 vjetorin e shoqatës patriotike "Vatra" në SHBA. Ai ndonëse është në mërgim, këtu ka prindërit dhe nënën Shqipëri. Kështu pra zona e Lekë Bibajve ka përse të krenohet për njerëzit dhe natyrën e bukur, e megjithëse në këto vite janë larguar shumë banorë, mendoj se në të ardhmen nuk ka përse të braktiset sepse ajo lidhet me Gjakovën, Kosovën dhe me gjithë Europën, gjithashtu ka perspektivat e një zone turistike ...

Nga PJETËR DELIA



# Kaltërsi në mes kështjellash

## - SHËNIME UDHËTIMI-

### Hyrje

Më së fundi e vendosa të udhëtoja drejt Shkodrës. Autobuzi ishte mjaft komod e shoferi simpantik, ku hera herës shquhej humori i hollë shkodoran. Dallohej e folmja e tij me dialektin e ëmbël e plotë muzikalitet të kësaj krahine. Udhëtuam përgjatë asaj rruge Fushë-Krujë-Shkodër që gabimisht në gjuhën popullore quhesh autostradë. Ky koncept ushqehesh jo rrallë nga masmedia, Kryetar, zëdhënës partish e qeveritar shqiptarë. Sa keq kur gjërat ngatërrohen edhe kur politikanët dhe njerëzit e këtij vendi kërkojnë të vrapojnë drejt Evropës së civilizuar kështu të çakërditur e të ... Jo për gjë, por duhet mbushur koka me kulturë e dijeni, se ëndrra nganjëherë kthehet në të kundërtën.

Kërkoj me vështrimin tim të përpjijë peisazhet e bukura e të shëmtuara, pyje në flakë e kosha mbeturinash të stërmeshura e që qelbin erë. Shënoi dhe bluaj me vete realitein e djeshëm e të sotëm.

### Madhështia dhe ...

Eci me hap të shtirimë, përgjatë urës së sapo përruar. Rrokullis vështrimin në kaltërsinë e lumit Buna, i cili më duket se nuk ecën. Sakaq, përfundon pjesa e saj prej betoni, kalimi këmbësor ngushtohet, duart më shkapeten ndonjëherë në hekurat e kryqëzuara. Qartë, është ajo pjesë që kur kalojnë anijet, ngrihet. E kuptohet çdo e mirë e ka një të keqe. I ngjanë urës së Gallatës në Stamboll. Veçse kjo është ndërtuar me mjeshtri e teknikë të re nga një ndërmarrje Italiane. Kuptohet projekti ishte i tyre. Edhe hekuri e çimentoja nga andej kanë ardhur. Ndersa gurët dhe uji ndoshta jo ...

Ndërkaq shikoi më sipër urën e vjetër e gjitha me kryqëzime hekurash, ku tani kalon një karroca, motorra e këmbësor. Edhe unë ish nxënësi i shkollës së Mesme Pyjore çdo të Martë, për dy vjet rrjesht e kalova në këmbë. Profesor Dedë Nikaj na udhëhiqte praktikat mësimore. Kërkonte disiplinë dhe rregull, ai shpesh thoshte: - Në rrjesht djelmoça, mos u shkëputni. Natyra në vitet shtatëdhjete dy të shekullit që lamë pas ishte më egër.

I zhytur në kujtimet e rinisë sime në Shkodrën loce, u ndodha në asfalt ku me kaloi një autobus i gjatë me targë Gjermane. Brënda ishin turistët që shikonin gjithëçka me kureshtje e habi. Pse jo, përballë meje një kodër gjigande shkëmbore me disa drurë kurorë gjelbërt, në majë, ngrihet madhështore një kala. Ngjyra gri dhe bedenat me kujtojnë luftat e panumurta që janë zhvilluar brënda e jashtë saj, kuptohet të lexuar në libra. Kundër ushtrive romake, turke, malazeze, serbe, dhe mishhtë më rrënoqethet, ndërsa muraja e sajë më duket si një shqiponjë në fluturim, ku nën të gjarpëron Buna shtratëgjërë dhe e kaltër. Të dyja sëbashku heshtin, bëjnë sikur vështrojnë njëra tjetrën, e gërryejnë në "lymrat" e shekujve për të rrëfyer edhe legjendën e Rozafës së murosuar.

Ulem në një karrige në klubin "Vataksi" dhe vështroi barkun e Taraboshit të zgavëruar. Dikur pak më sipër ka qenë një fabrikë çimentoje që vllte tymra e pluhura ditë natë, duke zhdukur bimësinë e gjallesat përqark sajë. Ndërsa sot është "ngrënë" me oreksin ciklopik nga skavatorë gjigandë dhe shpërthime dhjetra kuintalesh dinamit, për ti shkeputur krijesën e miliona vjetëve, gurin. Kjo zgavër gjiganteske që të tremb, të shemton mimikën dhe të shkatërron mushkuritë me pururin që nxirret nga puna për thyerjen e gurëve e lëvizjen e makinave shumëonaltëshe.

Nuk kaloi as një kilometër dhe shikoi buzë rrugës, mure kalaje, por me gur të vegjël

e cila të lenë të kuptosh se është ndërtim i viteve të fundit. Pyes Ylberin: Çfarë është ky ndërtim madhështor, me një planimetri kalaje? Ai fillon me zërin e tij të qetë, se është vepër e shkodoranit Ridvan Meti me banim në Amerikë ka ardhur dhe e ka ngritur këtë krijesë të rrallë, duke e kthyer në restornt, kafene, vend ku bëhen edhe dasmat. E ka emnuë Kështjella "Iliria". Aty në atë shpatë mali ishte thurur, arkitektura e kështjellave ilire, me shijet e të sotmes, ku kat pas kati



shpalosen bukuri tërheqëse. E ndërsa më kujtohet një fotografi në ndërtim e sajë, në faqet e fundit të librit "Ana e malit (Oblike)", viti 2007, me autorë Ruzhdi Poda. Dhe pyes veten: sa vite kanë punuar për ta ndërtuar? Vetëvetiu më ngrihet supet. Ndërkaq vështroj matanë hapsirave të kaltërta, kishën e sapo ndërtuar nën këmbët e kodrës shkëmbore. Këtu, në mijëvjeçarët e shkuar e ka patur filluesin e saj Shkodra, sot qytet me shtirirje deri në fushën e Shtoit në Lindje, Kirin në anën veriore dhe bregun e liqenit të Labiatëve në krahun Prendimor.

Përpiqem të ngjiz, të thur, personazhet e mbretërve Ilir: Hylli, Bardhylin, Gencin, Agronin, Pleuratin, Teutën me kryetar Qeverishe, mbretër, pashallare që të realizoi një paraqitje sa më reale të peisazhit historik me ate natyror të cilët duhet të shkëlqejnë me ngjarje, e transformime epokash në të mire të shqiptarizms. Por a ka ndodhur gjithmonë kështu?

### Kështjella e mbretit

Misioni është, për të gjetur një dëshmi, për të zbuluar një të vërtetë të groposur në humnerat e shekujve. Pak dritë, si ajo e xixëlonjes ne pranverë. Ashtu lozonjare fiku e ndizu, duke fluturuar me shume lakore. Por kur e ndjek të tërheq, të shtyn kurioziteti për ta kapur e shikuar me imtësi si funksionon ky mekanizëm biologjik ndriçues, kaq bukur, mahnitëse, tërheqëse, edhe unë e ndjek me kureshtjen e një fëmije lozonjar.

Lexova para disa vitesh në një punim historik të historianit Italian, Jordan Ferlunges, mbi kronikën e priftit të Doklesë. Gradikna kundershtari i mbretit serb Gjorgjo, lenë në Kështjellën e Oblikës nipin e tij. Ngjarja zhvillohet në fillimet e shekullit të dymbëdhjetë.

Fillova kërkimin duke "zhbiruar" në memorjen e banorëve të këtyre viseve. Me ndihmën e Ilirit po ndjekim rrugën përgjatë një

kurrizi e cili quhet pylli i Gushës, në drejtim të majës së Vizit. Jo rrallë na fshikullojnë krahët ose këmbët degët e dëllinjave, frashërave apo murrizave.

Arrijmë tek kodra e Prehës, pikërisht këtu e braktisim, udhën e sapo ndjekur, dhe marrim një ish kanal uji që mezi duket vende-vende shenjat. Këto shpate që tani të mbushura me fierëra, një metër përse jo edhe dy ndonjëherë, kanë qenë rritur zerdeli dhe qersh. Pas viteve nëntëdhjetë u prenë dhe u

verior të Taraboshit, edhe ky në vitet njëmi-je e treqind e katerqind quhesh mali i Shën Markut. Me një brez të djegur, ku ngjyra e zezë bën shumë efekt me gjelbërimin e sipërfaqeve të pjerrta. Më poshtë, syri të rrok Rrahanait e Zusit me ullishtat kurore argjende, të cilat me kujtojnë aksionet e shkollës sonë, duke hapur brezare e mbjellë ullinj. Kuptohet vetëvetiu të dielat, që ne duhet ti bënim pushim. Por nuk ndodhte kështu.

Ndërsa në drejtimi jug prendimor në cepin e kësaj rrafshine ndodhet një gropë gjigande me gurë e copra çimentoje të cilat e kanë kaluar shekullin. Mos u habitni, edhe Austriakët kanë ngritur fortifikimet e tyre para ose gjatë luftës së dytë botërore. Vështroi kurrizin maje maje të Abaz Salës i cili zbrit ashtu ëmbël ëmbël drejt anës lindore të Oblikës. Ndërsa ndërtesa ku brënda ndodhen pompat e fuqishme të cilat thithin nga Buna ujin e sajë për të ushqyer kulturat e ndryshme bujqësore e pemët frutore.

Duke studiuar me imtësi, gjithëçka përreth meje dhe në hapsirën e paanë shtroi pyetjen: Amund të ketë qene këtu ajo kështjelle, ku "... perandori Bullgar Samuel zuri rob, aty rreth vitit 1000, princin serb Vladimir... ?!

### Ishulli i pafatë

Makina e drejtuar nga Bardhyli duket sikur rrëshqet asfaltit të ri. Emërtimi i ri i sajë "Ulqini" është një buçitje e historisë mijëvjeçare Iliro-Shqiptare. Pranë thertoresh tek kjo ndërtesë poshtë rrugës për në Shirok, e cila që nga vitet shtatëdhjete e ka patur këtë funksion. Të therë e coptojë, pa të keq, kafshët shtepiake ku njeriu i ka zbutur qindra e mijëtra vjetë më parë për ti vënë në shërbim të tij. Ndërsa gjakrat, jashtëqitjet, ujrart e pista e të tjera derdhen pa të keq në ujrat e Bunës. A intrrosohet ndokush për mbajtjen pastër të këtyre mjedisëve ujore? Me sa duket askush!

Pak më tej degëzohet në pjesën e malit, një rrugë e ngushtë automobilistike, vepër edhe kjo e ndërtuar nga Austriakët, e cila ngjitet deri në majën e Golshit. Ende duken pishat e mbjellura nga nxënësit e shkollës së Mesme Pyjore. Ato i mbillnim me sheshe, gradone e gropa me pjerrësi nga mali, në mes shkëmbenjëve gëlqeror. Ende aty këtu jeshilojne selvitë, pishat e egra të cilat iu kanë rrezistuar rresbesheve të kohërave.

Kalojmë kthesën ku kaltërsia e liqenit të rrëmben, duke të dhënë një kontrast me shkëmbinjët gëlqerorë madhësi ndryshëm, e ndonjë shtëpi e ndërtuar vonë me pak gjelberim përrreth te cilat të japin imazhet e oazeve të shkretëtirave të Saharas. Mbretëron një qetësi e pa imagjinueshme, e kërkoi të zbuloi nga lashtësia, nëse kemi patur banues në këto bregore. Sipër thertoresh mbi një masë shkëmbore, ka qenë, dhe tanimë e sapo rindërtuar kisha Shën Mëria e Magdalenës, e përmendur edhe nga Barleti në vitin 1477, dhe më tej kanë vazhduar Kisha e Shën Kollit dhe më tej Shën Andou i Padovës. Me sa duket ky breg ka filluar të ripullohet, duke i dhënë vendit një gjallëri të veçantë. Ndoshta me kohën do të gumzhijë nga më me shumë njerëz, e institucione të tjera në shërbim të tyre.

Jo shumë larg bregut biskon një ishull, më shumë shkëmbor se sa tokë, mbi atë dallojme shenjat e një ndërtese, me kollona e harqe betoni. E papërfunduar. E mjeruesja në mes kaltërsisë të ujrave që ndrisin nga rrezet e diellit. E bukura dhe e shëmtura në simbiozë. Diçka pikërisht këtu ka kërkuar të lind, bukurindjellëse, si një akropol i lashtësisë, apo si një grataçelë njujorkeze. Por fatkeqësisht ajo ka mbetur vetëm një dëshmi e një ëndrrë të porealizuar, të vyshkur, të coptuar.

(vijon në numrin e ardhshëm)

Ngja Dr. SELMAN MEZIU, Firenze

# Kodi i vetmisë si kodi i kohës eterne, ndryshe Kodi i "Dimrit të vetmisë së madhe ..."

Si student i fillimviteve "70-të, në UT, s'mund të harroj lehtë ndjesinë magjike, misterin që do të sillte mes nesh romani "Dimri i vetmisë së madhe" i Kadaresë. "Jo sipas motit e lagështirës së kritikës militante, por në frymën e kritikës letrare akademike" siç do të na këshillonte Umberto Eko, kritiku i madh italian, mendova t'i rikthehem si një lexim krejt ndryshe, tashmë në liri, këtij romani, ndryshe edhe si një obligim ndaj mungesës së një ballafaqimi serioz të kritikës sonë me Kadarenë sa real, sa surreal.

Larg formës retorike të studimit të një romani synimi im kësaj radhe është evidencimi i atij "leximi" që, si për shumë vepra të tjera të letërsisë sonë të traditës, nuk është bërë këto vite, me nëntekstin politizues: sa paragjykes, sa asgjësues si "vlera muzeale", apo thjesht historike, as për "Dimrin e vetmisë së madhe" të Kadaresë.

Le të stacionohemi në dy personazhe, fare episodikë, njerëz të thjeshtë, "përfaqësues" të klasës në "fuqi", sipas doktrinës komuniste: Xani dhe Rremë Huta, i pari fotograf, i dyti fshesaxhi. Xani, me vetëdijen revolucionare se pushteti fitohet dhe mbrohet me pushkë, fillimisht vjen në punë me armë (revolver), por, me kalimin e kohës, "për çudi ai u urtësua", harron revolverin dhe në govatën ku lan fotografitë, ndjehet si në "mbretërinë e përrallave", ndërsa Rremë Huta, që vigjilencën revolucionare e shikon në kufinj të pragmatizmit të tij: Fshesa, puna, vetvetja. "Qesh, qesh, por më duket ma fute, i thotë një qytetari të huaj": Ndërkohë që "pritej" vigjilencia (jetojmë apo jo në bllokadë), Rremës i erdhi papritur keq për të: "Kushedi si e ka hallin, i shkretë!" nënvizon autori... Si njihemi me të rinjtë e Rrugës së Dibrës mes të cilëve edhe Arben Struga, si dhe një vajzë me emrin "Kriza e përgjithshme e kapitalizmit", ideologjikisht, si një ironizim me heretikët konservatorë që i tmerroi liberalizmi i fillimviteve '70-të, autori përmes një digresioni na kalon tek një episod në vitet e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare: Një ulkonje kërkon dy këlyshët e bllokuar në një shpellë në një ditë me dëborë, ku Raboja nëna e Besnik Strugës, gjatë bombardimit struket me "këlyshët" e vet, Besnikun dhe Arbenin. Këmbëngulja e ulkonjës për t'ia dorëzuar të vegjëlit, të kujton rolin determinues, të instinktit tek njeriu për të ndërjer gjithçka nga vetvetja. Sikur të thotë t'i mund të më imponohesh, por në thelbin tim, ndryshe sado të më kesh "pushtuar", ti nuk ke arritur të qenëshishmen time. "Truri i Rabos bëri një përpjekje për t'u çliruar nga mpirja dhe e kuptoi më në fund se ç'duhej bërë", - nënvizon autori. Ndërsa duke u referuar kandidatit të partisë, Besnik Strugës, ai vazhdon: "Për dy javë ishte vërtitur në ca kooperativa fushore, ish-prona bejlerësh. Atë që quhej përkatësi, urrejtje, ndarje klasore ndjeu papritur t'i shpalosej nën këmbë... ishte diçka e pafund, e rëndë, e përsëritshme në shekuj", sikur të thotë po ne ç'ndryshuam, aq më keq prekëm negativisht thelbin tonë. Besniku është mjaft skeptik, aspak euforist; ai kurrsesi nuk verbohet para faktit. "Mund të harrosh një qilim persian që të kanë marrë, - i thotë ai Zanës, por një tokë të tërë kurrë. Po të ishe ti me mua atje dhe të shikoje se ç'na kanë bërë dhe ç'u kemi bërë, do të mendoje ndryshe", i thotë ai Zanës. Simpatia e autorit, larg çdo entuziazmi, lexohet qartë. Ja një tjetër kuadër: të rinjtë që quajnë ta shijojnë kohën, në mënyrën e vet, kur prindërit s'janë në shtëpi: Çlirimi, Beni Irisi, "Kriza...", Sala që s'e njohin të jetuarit si rini revolucionare sipas motos së kohës: "Një bije, mijëra ngrihen"

(moto revolucionare e kohës). Nën një dekor idhnak, lëvizin në roman, gjithë format ansambël të jetës, dekor që nuk të ndahet për asnjë moment: në rrugë, në mjedise publike, në familje. Kadare, tashmë, i çliruar plotësisht nga idolatria, skema, na fton drejt një poetike postmoderne.. Duke përshkruar portretin e shefit të kuadrit, Kristaqit, që ka në dorë si "rregull" monopolin e partisë-kuadrit, Kadare nënvizon: "Besnikut iu duk pa pritur se në nofullat, mollëzat, ballin e zeshkët dhe sidomos në vendosjen e vetullave të tij kishte diçka si shkronja "Z". Penelatat e holla të autorit, detajet karakterizuese, shpesh si të një bashkësie, zhvendosja e vështirimit të autorit nga një rrafsh tek tjetri, si dhe mpleksja e verbit autorial me atë të personazheve, krahas ndërhyrjeve e ndërfutjeve në rrjedhjen e thyer të subjektit, i japin arkitekturës së romanit ridimensionim përmes marrjes e rimarrjes së herëpashërshme të spuntove nga momentet kyçe të boshtit subjektor apo episodeve digresionale. Simbolika kontekstuale dhe detaji - diçka nga shkronja Z (zi) rimotivon një rrokullim më të shpejtë të ngjarjeve. Kur ti mendon se ky shef kuadri, gjurmues biografish në profilin e tij, mund t'i bëhet pengesë Besnikut me çëçëllimat që vijnë nga krimbnaja të llojit Aranit Çorraj, një koçixoxist i thekur, mëson se shefin e kuadrit (monopolin e Partisë) "kur nuk na duhet" s'e pyet njeri Ai thjesht të duket sikur leh si qeni në hënë... "Portrete të reja u dukën atje të palëvizshëm. Ishin anëtarë të Byrosë Politike të KQ të Bashkimit Sovjetik. Roma e tretë, tha me vete Besniku". Nuk është e vështirë të lexohet nënteksti i fuqishëm. Jemi përpara llojit të një kështjelle Moskaroma apo Romamoska, stilema të goditura kadarejane, ku vëllai do të hajë vëllanë. Kuptohet, kësaj radhe vëllai i madh, Romai, do të vrasë vëllain e vogël Romelin. Roma e tretë (Kremlini) mendoj, - vazhdon autori: "Dhe vendi i dikurshëm i prerjes së kokave ishte atje midis sheshit, mjaftonte që të mënjanohehin pak statujat prej bronzi të Minjinit dhe Pozharskit". Ja mesazhi: Atëhere doni, apo s'doni ta kuptoni: Ju po e demaskoni këtë qëndrim mes "Romajve" e "Romelëve", ju s'do të njihni më një Romë të tretë (Kremlinin). Atëhere, (nënteksti) na mbetet një finale e madhe: Braktisja e kësaj lukunie ujqërish... Dhe, nëse ju e braktisni, unë, si artist, kam të drejtë të përjetoj, sipas mënyrës sime të shijes, seriozitetin historik të këtij hapi të vendit tim. Pikërisht këtë hap hodhi Kadare. Ndarja me perandorinë ruse në 1961-in që një lëvizje cilësore, që përfshiu të gjithë sektorët e jetës: Vëmendja e letërsisë sonë, me shpresën e ndarjes nga soci zhdanovian, do t'iu drejtohej vlerave të folklorit, si amë, që do t'i ushqente rrënjët e qëndresës në ruajtje të identitetit tonë kombëtar: "Si mjeshër i vjetër, i thirrur në detyrë, eposi po bëhej gati t'i hiqte ngjarjes pjesët e saj të buta, të vdekshme, alo, po, po...ta gurëzonte duke e bërë kështu të parrishshme nga çdo rrebesh" shprehet autori. "Objektiviteti", si kriter substancial i romanit bashkëkohor, me tre komponentët e tij: paanshmërinë, drejtsinë dhe gjakftohtësinë, i japin autorit më shumë frymëmarrje, ridimensionim të vetvetes dhe krijesës së tij, në vazhden e romancierëve më të mirë të shekullit. Vërtet e ndjen veten komunist Besnik Struga, por jo "si Muça pas daisë": "Unë jam komunist dhe kjo është gjë e brendshme më shumë sesa e jashtme tek njeriu", .... vetëm si pjesë e tij", - kurse pjesa e ajsgbergut (më e madhja) shfaqet vetëm në çaste rrezikimi të revolucionit". Komunizmin, si "çështje e përbashkët", ai e ndjen krejt ndryshe, jo si

"çështje e të gjithë popullit", por si çështje e kombit edhe e partisë... Autori përdor fjalën revolucion, jo komb, për të qenë i kujdesshëm me kompromisin ekzistencial, por nënteksti është i qartë: Cila, thotë Besniku, është prova? Ja, kjo që kërkon momenti historik! Tek ky i fundit Besniku lexon kombin, Atdheun, kurse censura patjetër "duhet", ka "të drejtë" të lexojë Partinë, çështjen e saj, idealin që kalon hapësirën e atdheut: "S'ka si të jem komunist gjatë procesit të ngrënies, pak mund të jesh në dashuri, pak më shumë në mbledhje, pastaj në punë e kështu me radhë", vijon ai. Kështu parimi i partishmërisë proletare, parimi bazë i realizimit socialist, sikur cënohet, madje injorohet. Dhe si për të na thënë s'di sa më kuptuat, por mua s'më lejohet të "shprehem" më tepër, autori vazhdon: "Besniku u bë e qartë se ai e kishte me zor të deklaronte në mbledhje, apo në mitingje se e jepte jetën për revolucionin, sesa ta jepte atë më të vërtetë". Dekori i romanit në asnjë moment, nuk paraqitet entuziast, rozë, por përgjithësisht i zymtë: erë, suferinë, shi, shi, shi: "Në Evropë kishte vazhdimisht mjegull, gjysma e Azisë ishte mbuluar qysh tani me dëborë" Një zymtësi që lexohet në të gjithë romanin, përjashtuar ndonjë episod të grupit të të rinjve, indiferentë dhe cinikë ndaj sloganeve. Ja si shprehet Arben Struga, djali i familjes së revolucionit: "Kush ta kërkojë stafetën, le ta mbajë". Me një fjalë, unë as nuk dua t'ja di këtyre lloqeve. Është fjala për qyqen "stafetë të revolucionit", që aq shumë vend zuri një gjysmë shekulli në auditoret e lloj-llojeve. Në anën tjetër, Xhemal Struga, (kanceros, metaforë e vetë sistemit totalitar) e ndjen veten, si "jashtëloje" nga vetë i biri, Besniku, kur kush është "Dikushi" ka marrë vesh Ngjarjen e Madhe... në kampin socialist.

Cili është definimi final lumtur i personazheve në këtë roman?

Asnjë si i tillë, asnjë i lumtur, asnjëri "burim frymëzimi" - jashtë ngjarjes si realitet historik, por i zymtë, qoftë fati i Besnikut apo i Zanës, shumë, shumë i vetëmjaftueshëm në luftën për gjetjen e vetëvetes me dinjitet: Besniku humbet Zanën, Zana humbet Besnikun. "Gjithë qenia e tij thirri: Zana! E kishte humbur Zanën", pohon narratori. I pari e kishte humbur Zanën si rrjedhojë e tejmasës së ngushëllimit balzakian, e dyta e kishte humbur Besnikun si refleksi i plotësisë shekspiriane. Njeriu nuk mund të jetë vetëm ajo që duket, por po aq e padukshme. Kësaj "mangësie", si mungesë e plotësisë të së tërës apo tejkallim të masës së ngushëllimit, Zana i përgjigjet si plotësim i vetvetes duke flirtuar me Markun, një i dekluar, pa pyetur fare për "deklasinim" e tij, edhe pse është vajzë zëvendësministri. Ndryshe asaj i mungon diçka që e plotëson. Faiku, si mjek e ka të qartë formulën e shenjtë të Hipokratit, megjithatë nën etheet e instinktit të plotësisë, ndryshe sigurimit të florinjve, duke u mbajtur në degën e origjinës, realizon pamje nga më makabret, që na kujtojnë egërsinë shtazarake të Kont Ugolinin të "Komëdia Hyjnore" e Dantes: Ja kuadri makabër: "Gatë, ngarkimit të kufomave mbi makinën e morgut për arsye... ndodhi diçka ngjethëse: që brënda trupit, në ijen e të vdekurit, u shfaq furishëm tehu i një thike. Doreza e thikës që duhej të gjendej jashtë, ishte brënda, tehu që duhej të ishte brënda, ishte jashtë. Dukej sikur vdekja kishte harruar rrugën normale të shfaqjes së saj". Nisur, thjesht, nga prania e emrit të diktatorit, personazhit "gogol", vepra gjithnjë ka qenë "shkak" denigrues pa të drejtë i vetvetes dhe i autorit. Atëhere kush është

personazhi i Enver Hoxhës? Nëse Hrushovi ka një trajtim të mangët, në komicitetin, babaxhanllëkun dhe gjakftohtësinë e njeriut liberal, për E. Hoxhën duhet thënë që dominon deskriptiviteti, ky jepet me tone, theks dhe kolorit që mbetet gjithnjë në kujtesën e lexuesit. Megjithatë, po të kemi të fituar brenda vehtes lirinë e "atvrasjes", sipas Frojdit, personazhi qëndror që mban gjithë ngarkesën estetiko-filozofike të subjektit në linjën e heroit "pozitiv" dhe qëndror është Besnik Struga, kurse E. Hoxha është më tepër një personazh historik, sesa i letrarizuar, ndryshe, ai vjen më tepër në kufinj të realitetit historik, sesa të reales artistike. Vërtet Hoxha shfaqet në momente kryesore të boshtit të subjektit si promotorr i dramaturgjisë së brendshme të veprës, por ai që "menaxhon" rrjetën e intrigës, që bart gjithë filozofinë dhe mesazhin qëndror në roman, si koka e një linje, është B. Struga-familja Struga, kurse E. Hoxha, në pikëpamje subjektore, s'është i tillë. Filozofia e E. Hoxhës - dogma staliniane: "nuk jemi dakort me doktrinën" - i vetmi tonalitet identifikues i tij - nuk arrin të bëhet filozofia dominuese e romanit. Objektiviteti i veprimit të tij është refleksi i vërtetësisë historike, kurse "objektiviteti" artistik si reflektim i filozofisë estetike të autorit vjen plotësisht si kriter substancial i prozës moderne. Ndo nëse së jashtëmi, Struga, duket si zëdhënës i mesazheve të Hoxhës, së brendshmi ata janë komunistë me vizion jo plotësisht të kundërta, por të bollshme si të ndryshe. Për Besnikun, armiqësia me Hrushovin fillon aty kur: "Ju na kërcënoni se do të na rrëzoni". Për E. Hoxhën armiqësia fillon aty ku ne nuk jemi dakord me doktrinën. Nëse për Besnikun komunizmi është diçka e brendshme, për E. Hoxhën ajo është gjithçka. Në funksion të dekodifikimit të këtij personazhi, kompromentues pa të drejtë i autoritetit artistik të romanit dhe vetë autorit, duhet pohuar se, nëse Struga vjen totalisht si figurë artistike, Hoxha, si personazh, afshohet përmes 40 faqëshit të arshivës plotësisht sipas konceptit postmodern të letërsisë si univers i vetvetes, ndryshe vetëm në atë sens që i përgjigjet së vërtetësisë historike, pavarësisht nga nxirja apo ndriçimi në reflektimin e saj. Ndërsa Hrushovi, si fenomen, heroi i liberalizmit sipas motos: Vilë, veturë, vajzë nuk shpalozet i plotë si maratonomaku i një epoke të re, megjithatë, në përjetimin e tij artistik, nuk lexohen doza të urrejtjes, lexohet kthjellët objektiviteti homerik.. Nata e "Zimave" të zinj vjen në roman si shumë netë e ditë të zeza të kalendarit politik të Evropës, ku synohej dhe u vendos zi e më zi për ne. Kësaj radhe ne e braktisëm këmbësorin e kësaj nate, por me një ndryshim tragjik: U përpoqëm ta modifikojmë, të origjinalizojmë modelin e kësaj këmishe, ndryshe ta shqiptarizojmë... E, nëse, gjatë kësaj analize, në ndonjë pjesë romani u duket ende i zymtë, apo i rëndë, nën ankthin e dramës që, ne, shqiptarët e përjetuam aq gjatë, "Dimri i vetmisë së madhe" sikur na thotë: "Unë gjithsesi jam juaji, jam pjesë e dhimbjes dhe e krenarisë, por edhe e tragjedisë sonë të përbashkët, për të cilën disesi u paralajmërova, por kurrsesi s'e shmangë dot, po aq sa nuk e merituar". E, nëse ndonjë "akademiku" do t'i duket anakronike rikthimi ndaj meje, mos harroni se fati ynë, përballë padrejtësisë globale, në emër të mbijetesës, sikur shmangia e kësaj "njolle" mbi shpinën time qenë po aq të pamundura, sa vetë kalvari i sakrificave tona si komb, sa njerëzore, sa territoriale, i tkurrur tashmë, maksimalisht, në kufinj të 28000 km2, ndryshe as sa 1/4 e Vetvetes.

Nga KADRI UJKAJ, kritik letrar

# MINATORI "alpinist" 60 vjet me varrë e çekiç ne dore

Para disa ditësh u nda nga jeta, ne moshën 79 vjeçare, minatori i famshëm Gjon Dede Martinaj nga fshati Lotaj. Gjoni qe e hante me dhembe shkëmbin, aty ku duhej te kalonte traseja e rrugës automobilistike apo hekurudhore. Gjoni punëtor i palodhur, i fjalëve te pakta, por i punëve te mëdha, një jete e tere mbi 60 vjeçare me çekiç e baromine ne dore, gjithnjë fitimtare mbi shkëmbinjë shekullor. Adresa e tij ishte ku kishte shpërthime, atje ku dëgjohej thirrja "minat...". Kudo neper atdhe!

Si gjithnjë pas vdekjes, kujtohem për te thënë e shkruar për vlerat e atij njeriu qe përcjellim për ne banesën e fundit. Gjithsesi jeta e Gjoni, meriton respekt e nderim nga ana e jone e te mësojmë prej tij. Le te ndalemi ne disa momente kryesore te jetës se tij:

1\*Ai lindi ne fshatin Lotaj, ne vitin 1933. Ne moshe te re, baba i vdiq e Gjoni duhej te merrte përsipër detyrën e drejtuesit te shtëpisë duke u rrite vete, por edhe duke rrite tre vëllezërit e motrën e tij ne moshe me te vogël. Faktikisht ne saje te punës e te shembullit te Gjoni, ata u rriten e iu futen jetës se tyre me dinjitet duke krijuar familjet e tyre e te mbara e punëtore. (Njeri prej tyre, vëllai i dyte, Nika një jave para Gjoni vdiq ne

moshën 76 vjeçare. Njeri punëtor, punonjës i vjetër i policisë popullore)

2\*Gjoni iu fut punës me vullnet e dëshirë duke ia filluar qe ne moshën 14



Gjon Ded Martinaj

vjeçare ne aksionin e pare te rinise, për ti dhënë Tiranës ujin e pijshëm te Selishtës. Si djalë i ri, u be ndihmës i një minatori te vjetër, për ta larguar nga puna e rende e krahut, e zgjodhi vete minator.

Se shpejti ai u be mjeshtër i barominës

e i çekiçit duke marre përsipër frontet me te vështira, atje ku shkëmbi ishte me i egër, atje derdhej munda e djersa e këtij vigani afro dy metra i gjate. Me vone ai vazhdoi ta ushtroje profesionin e fituar si aksionist ne rrugën e rinise Kukës-Peshkopi, ne aksionet zinxhirë për ndërtime e rrugëve te hekurta neper atdhe. Gjoni u be shume i njohur, prandaj dhe kërkohet kudo. Tani e kane radhën rrugët automobilistike ne zonat malore te rrethit tone. Mjeshtri projektues, i mirënjohuri Bep Malaj, për te realizuar projektin e tij, atje ku duhej e pamundur thërriste Gjoni për t'u konsultuar me te. Kur Gjoni thoshte "po" edhe Bepi thoshte ketë shkëmb e çan Gjon Deda. Kështu ndodhi, ne vitin 1964, kur duhej çare shkëmbi monolit për rrugën Theth-Breglumi, për kalimin e rrugës automobilistike Breglumi-Prekal nga karma e Kirit. Por, prova me e vështirë për Gjoni ishte hapja e rrugës se Malësisë se Madhe, atje ne mes shkëmbit i lidhur me litar.

Edhe alpinistet ne këto shkëmbinj e kishin te vështirë për t'i ngjitur, kurse Gjoni jo vetëm do t'i ngjitej me litar, por atje do te qëndronte duke e goditur me mjetet e tij te punës, jo thjeshte për te hapur vrime, por tunele ku do te vendosej lënda eksplozive me arka, e me vone te realizonte shpërthimin masive mu ne zemër te shkëmbit.

Gjoni ishte model i njeriut korrekt ne pune e ne jete. Ishte shume i përpiktë ne zbatimin e rregullave te sigurimit teknik, prandaj atje ku punoi e drejtoi ai, asn-

jëherë nuk pati aksidente për veten e tij, për punëtoret ose te banoreve te atyre zonave ku punohej.

Gjoni ishte dhe një familjar i mire. Mirësia ishte tipar i tij, jo vetëm me Lezen, bashkëshorten e fëmijët e tij, 3 djem e tri vajza, por edhe me vëllezërit e bashkëshataret. Mungesën e Gjoni ne shtëpi se, shpesh punonte larg shtëpisë, Lezja e përballonte me vendosmëri e përkushtim duke i rritur e edukuar fëmijët si me mire. Ata, sot janë rritur, secili prej tyre ka krijuar familjen e vet duke qene një pasqyre e prindërve te tyre, te thjeshte dhe te ndershëm.

Vitet e fundit, jeta nuk e përkëdheli Gjoni, përkundrazi u vu përsëri ne prove karakteri e forca e tij, por tashti me dy "shkëmbeje" me te vështirë e jetës se tij. Atëherë, kur kishte nevojë me shume se kurrë, humbi bashkëshorten e tij besnike. Pasojat e një pune te rende e te gjate e humbja e Lezes, bën qe sëmundja profesionale ta lodhin ne pleqëri. Por, Gjoni nuk u ligështua, por e përballoi situatën e re ne saje te karakterit te tij dhe te kujdesit te familjareve, te djemve, te vajzave e te tjerë. Jeta e Gjoni është histori me vuajtje e sakrifice te mëdha, me pune te palodhur e vullnet te forte, por me bindje se munda nuk i shkoi kote. Ai la një emër dhe te nderuar e te respektuar, por na la dhe tre djem e tri vajza, njeri me i mire se tjetri, te vendosur për te ecur ne gjurmët e jetës se ndershme te babës se tyre.

Nga NDOC GRIMA

## JU SHKROFTË EMNI ME SHKRONJA TE ARTA

Dukagjinasi gazetën mori  
Sheh ne te një gja t' madhe  
Me portretin e një malsori  
Qe i jep fryme me ndej gjalle

Ky Ndue Ftoni djalë i Shoshit  
Le e rrite asht ne malsi  
Bekimin mori prej Zotit  
Me ruejt nder edhe burrni

Ne pah vlerat i ke qite  
Qe u mbushen për shume vite  
Mësove te vjetrit e te rite  
Me i dal zot ksaj tradite

Male e shkropa ke rinue  
Se lodh dimni as s'e lodh vera  
U hoq Imushqet qe paten vnue  
Dhe njiqind vjet duken ma te reja

Kan qit pushke kur ka le djalë  
Kjo tradite ruhet dhe sot  
Ne histori duhet me e lanë  
Për ksi djemsh me qit dhe top

Rranjët e lisave lshojne dege  
Dege te forta qe kurr nuk thahen  
Trupi i tyne plot me vege (rrefana)  
Ku traditat aty fort mbahen

Ky mundësor zemër bujra  
Ju dha dorën jo me ba emen  
I ban thirrje malsise mbare  
Leni pushkën e merrni penën

Ka dhanë shenjen e kushtrimit  
Te ruajnë traditën qe kan pase  
Me shtri dorën e pajtimit

T' jetojmë n' harmoni e n' paqe

Shume gjana sot kan ndryshue  
Por dikujt s'i hum kurr vlera  
Ku ka ken prap ka me shkue  
O Ndue Ftoni tu rrite ndera

Ketij njeriu me njenja te pastra  
Qe ka ba akt sublim  
Ju shkroftë emni me shkronja te arta  
Ne maje te bjeshkëve ne Dukagjin.

VATE BASHAJ, GJERGJ ÇUNI

## SHENJTËRESHA E VËRTETË

Nënë Terezë e dashur,  
në tërë boten shkove,  
por vendlindjen tënde,  
kurrë nuk e harrove.  
Në Kalkutë të Indisë,  
humbe, u trete  
por për botë të mbarë  
në histori mbete.  
E vogël jam,  
por ndihem shumë krenare,  
për Nënë Terezën,  
që është shqiptare.  
U lute te Zoti,  
të na bekojë me liri,  
tani vepra jote lutet,  
edhe për një Shqipëri.  
Te ti, moj Nënë Tereza,  
do të lutemi përjetë,  
ti gjithmonë ke qenë,  
shenjtëreshë e vërtetë.

JEHONA GASHI

## "IM ATË ROBIN HUDI"

Poezi satirike

Baba im, legjendë Dukagjini,  
Veç një Zot e di se kush e lindi,  
Aq sa edhe sot vazhdon kundërshtimi,  
Secili po thonte: djali asht i imi.

Në sytë e tij Shqiponja bante bër,  
Dragoi thonte krahët unë ia kam prë,  
Gjyshja po kambëngulte: asht biri im  
Rrahte gjoksin gjyshi: grueja ma ka lindë.

I kujt që e s'që, pak ka randësi,  
Mjaft ta dijë bota, që unë jam i tij,  
Merre si ta marrish, s'jam as unë ma pak,  
Jam pors kodra që rri përmbi shpat.

Ka qenë i madh, shtatin si një lis,  
I bukur, i kandshëm, nder për gjith' fis,  
I mençun ishte, si askush n' atë anë,  
Lumja, thonte nana, çfarë burri kam marrë!

Deri ku rrok syni e njihnin bajraktar,  
Shtatë copë katunde mbrapa i kanë ardhë,  
Ka pleqne halle, ka lanë edhe fjalë,  
Mbarë njerëzia sot n' gojë ato i mbanë.



Jehona Gashi

Me hir e pa hir, të gjithë e kanë dashtë  
Përveç do spiuna serb nëpër kashtë,  
Që fshahun rrinin nëpër bira t' munit,  
Si dikur Hitleri prej bombardimit.

Bubullimë ishte n't' Dukagjinit Lug,  
Trim i rrallë vërtetë, pors Robin Hud,  
Një jetë për Atdhe ai tue luftue,  
Anmiqve tmerrin n' asht ua ka çue.

Që rebelue për një kafshatë jetë,  
Për një rend të ri, pa maskarallek,  
Ku të kishte bukë, kripë e pak lezet,  
T' përbashkuem e donte " kombin e vet".

Ai nën komandë ka pasë një ushtri,  
Sharofin e mbante për zevendës të tij;  
Në t' gjitha betejat përpara u ka pri,  
Mjerë ata livadhe ku ai ia ka mësy.

Po vdiq një ditë e nami mori fund,  
Kush ma s' kujton t' madhin Robin Hud,  
Pos meje, nanës, dhe motrave të mija,  
Gjedhëve të shtëpisë e deleve të tija.

ÇLIRIM UÇA



Çlirim Uça

# Festivali i 50-të nacional i këngës për fëmijë!

Me datën 4-6 korrik 2012 ne qytetin e Teutës, Shkodër, u zhvillua Festivali Nacional i Këngës për Fëmijë.

Personeli drejtues i këtij Festivali ishte: Drejtor i Festivalit - Kujtim Alija Udhëheqës artistik - Roland Guli Regjisor - Osman Mula Skenari - Manjola Lloja (Bushati) Skenograf - Adnan Kastrati Redaktor përgjegjës - Bardhyl Hysa Folës - këngëtarja Rosela Gjylbegu dhe aktori i humorit Julian Deda

Organizatorët dhe drejtuesit e këtij festivali kane menduar qe ketë here fëmijët te këndojnë jo ne Teatrin "Migjeni", por ne hapësirë, ne një skene te ndërtuar ne rrugën "Shëtitore" te qytetit te Shkodrës, me qellim qe qytetaret te jene me shume pjese e këtij evenimenti artistik dhe te shijojnë me shume tingujt e muzikës se këngëve te fëmijëve.

Ne ketë eveniment morën pjese fëmijë te moshave te ndryshme, jo vetëm nga Shqipëria, por dhe nga Kosova, Mali Zi dhe Maqedonia duke i dhënë festivalit formatin e një aktiviteti kulturor mbare-nacional.

Në natën e dytë te festivalit mbarëkombëtar të fëmijëve në qytetin e Shkodrës përpara artdashësve shkodrane janë interpretuar 48 këngë te zgjedhura gjate 50 viteve, te cilat janë interpretuar nga 80 këngëtarë.

Ne natën e trete, ne natën finale, janë kënduar këngët finaliste dhe janë ndare çmime përkatëse. Janë ndare 3 çmime te treta, 2 çmime te dyta, si dhe shume çmime te tjera për 24 këngëtarët.

"Pse u mërzi mami", është kënga fituese e edicionit te 50-te te festivalit te fëmijëve ne Shkodër, te cilën e interpretoi këngëtarja Mishela Rapo nga Tirana, me muzike dhe tekst te Adrian Hiles. Kënga ka marre vlerësimin maksimal te jurisë ne Shkodër.

Pak histori

Duke ndjekur festivalin e 50-të të fëmijëve të Shkodrës nuk ka se si të mos shkojë mendja në vitet 60-të, ku përveç festivalit të fëmijëve, lindi dhe Festivali i Këngës në Radiotelevizion. Në vitin 1963, ishte Festivali i parë i fëmijëve në Shkodër. Iniciativat e muzikantëve të atëhershme vunë në qendër të vëmendjes një shpërndarje të festivaleve dhe muzikës për fëmijë.

Organizimin e Festivalit të fëmijëve të Shkodrës e kishte Ministria e Arsimit, Ministria e Kulturës, Lidhja e Shkrimtarëve dhe Komiteti Qendror i Bashkimit të Rinisë. Ishin këto institucione që organizonin Festivalin paçka se realizohej në Shkodër. Ato shpallnin konkursin e këngës për fëmijë dhe pionier. Në fund të viteve '80 festivalet patën një organizim

të tillë, në Shkodër shkonin këngëtarët dhe çmimet e parë të çdo festivali që bëhej nëpër rrethe. Ishte një ekip i ngritur, një komision që përbëhej nga një kompozitor, regjisor letrar, poet që ishin të gjithë të natyrës së fëmijëve, dhe aty merreshin këngët më të mira të këtyre festivaleve te rretheve. Këngëtarit dhe kënga më e mirë shkonin në Festivalin Nacional në Shkodër. Fëmijët shoqëroheshin ose me prindër ose nga shtëpia e pionierit nga vinte fëmija. Në festivalet e para në Shkodër drejtues ka qenë Tonin Daia, ai ka qenë dirigjenti i orkestrës së fëmijëve. Kishte edhe orkestër simfonike

historia ehte ajo qe është dhe nuk ndryshon për dëshirën e kurrkujt. Historia nuk fillon me mua dhe as me ty. Ajo ka filluar breza me pare, jemi pjese e kësaj historie dhe ne qe jemi sot, ashtu siç do te jene pjese e saj dhe brazat qe do te vine.

Refleksione

**Se pari**, nuk e vlerësoj zhvillimin e këtij festivali ne hapësirë. Kudo, aq sa kame pasur mundësi te ndjek, festivalet janë zhvilluar ne salla te mbyllura. Festivali i fëmijëve, siç çdo festival tjetër qe nuk duhet te kthehet ne manifestim popullor. Festivali i fëmijëve nuk është pjese e ndonjë manifestimi popullor, nuk është

Shkodrës, Qendra e Kulturës se fëmijëve, Shoqata Shpirti Artistik i Shkodrës, RTV Shqiptar, me mbështetjen e MTKRS-ve, Ministrisë se Arsimit dhe Shkencës, Drejtorisë Rajonale Arsimore te Shkodrës, nen kujdesin e zonjës Jozefina Topalli, Kryetare e Kuvendit te Republikës se Shqipërisë ...". Me duket se, është e jashtëzakonshme te kryesh detyrën për te cilën populli paguan taksat dhe prandaj duhet gjithë kjo reklame! Cila nga këto institucione nuk kane detyre funksionale PR te organizuar, përgatitë dhe zhvilluar vepërimtari artistike e kulturore?! Prandaj, e quaj je publikim te tille një hipokrizi. Pse,

po sikur zonja Kryetare te ishte nga Gjirokastra, do te publikohej: nen kujdestarinë e saj? Me siguri jo. Ne nuk jemi ne fushate elektorale. Para disa viteve, një pushtetar kërkonte ti bënim një reklame ne njërin nga televizionet lokale te Shkodrës, dhe na tha: "E paguaj unë spotin, por te theksohet ne fund: Nen kujdestarinë ...". Hipokrizi është pak ta pagëzosh.

**Se treti**, festivalet janë evenimente artistike e kulturore, çka do te thotë se janë te fushës se artisteve, te krijuesve, te muzikologëve e te tjerëve. E quaj jo normale daljen ne skenën e festivalit te pushtetarëve te qytetit dhe te Qarkut te Shkodrës, te deputeteve te Shkodrës, te Ambasadorëve siç qe ai i BE-se dhe i SHBA-se, deri Drejtoresha Rajonale e Arsimit për Shkodrën, dhe te japin çmimet qe kishte caktuar juria. Jo me kot, folësi, aktori i humorit Julian Deda, ne mes te tjerave thoshte: "... Hajde një tufe me pari ...!". Ne atë skene duhet te ishin ndonjë nga këngëtarët ne vite, ndonjë krijues tekstesh te këngëve ne vite, ndonjë kompozitor te këngëve ne vite e tjerë personalitete te këtyre fushave te kulturës e te artit qe nuk janë pak qofte ne qytetin tone, por dhe me gjere. Ku është Shkodra "Djepi i kulturës"? Kaq, servilë jemi, sa kërkojmë te na thonë ndonjë fjale te mire te huajt, dhe aq me tepër kur është përfaqësues i një shteti te madh, nëpërmjet te cilave kërkujmë te mbulojmë paaftësinë tone, te mbulojmë gjendjen tone te mjeruar, te mbulojmë mungesën e kulturës sonë. Zotërinj nuk jemi ne fushat elektorale!

Nga Ndue Sanaj

REDAKSIA

Kryeredaktor: Lazër Kodra  
Redaktorë: Albert Marku,  
Drita Shyti, Roza Pjetri,  
Prelë Milani, Luigj Shyti,  
Suela Ndoja, Zef Nika,  
Florenc Buxha, Lulash Brigja



të cilën e drejtonte Prenk Jakova. Në fund të viteve -80-të ka qenë Jetmir Barbulushi që ishte dirigjent dhe shumë organizatorë të tjerë.

Pas viteve '90, nuk ndryshojë përgatitja dhe zhvillimi i këtij festivali. Ai vijon ne qytetin e Shkodrës dhe çka ehte me e rëndësishmja, numri i festivaleve nuk ka ndryshuar. Kjo duhet theksuar më me force, se indirekt apo drejtë perse drejti luftohet ai mentalitet: "Historia fillon me mua". Ky mentalitet jo ne pak raste na ka munduar, kemi mbete peng e saj dhe nuk na ka lanë te ecim përpara, kur ne fakt

pjese e ndonjë fushate elektorale. Prandaj, duhej te zhvillohej ne Teatrin "Migjeni". Me përfundimin e tij, Bashkia dhe organizatorët e tjerë le te organizonin një koncert ne sheshin "Luigj Gurakuqi", apo "Nene Tereza", apo edhe ne "Shëtitoren Kole Indriomeno".

**Se dyti**, nuk kuptoj gjithë këto reklama për ata qe kane për detyre te organizojnë, te përgatisin dhe te drejtojnë këto festivalet. Nga folësit, nga mendja e shkruar dhe vizive publikohej me te madhe: "... Festivali i 50-te Mbare-nacional i Këngës për Fëmijë u organizua ne Bashkia e